



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:032809

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830715

PPS.nr.12/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL, Trupi gjykues në përbërje prej kryetarit të trupit gjykues Ngadhjim Arni dhe anëtarëve të trupit gjykues - gjyqtarëve profesional Mentor Bajraktari dhe Lutfi Shala, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arlinda Rexhaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarve J.D dhe S.S, për shkak të veprës penale Krime lufte kundër popullatës civile, e cila parashihet dhe dënohet me nenet 22 dhe 142 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tutje KPRSFJ), e që në kohën kur është ngritur aktakuza ishte penalizuar me nenet 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 04/L-082), tutje (KPRK) e cila është në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët dhe nenin 4 të protokollit shtesë II dhe të gjitha rregullat e të drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me shenjë PPS.nr.88/2012 të datës 06.11.2013, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të hapur për publikun, të mbajtur me datën 22.04.2024, në prezencën e Prokurores Speciale Florije Salihu Shamolli, i akuzuari J.D, me mbrojtësin e tij me autorizim në shkresat e lëndës Avokat Mexhid Sylja, si dhe i akuzuari S.S, me mbrojtësin e tij me autorizim në shkresat e lëndës Avokat Artan Qerkini, me datën 25.04.2024 publikisht shpalli, ndërsa pas kërkesës për vazhdim të afatit për përpilimin e aktgjykimit, në afatin e lejuar ligjor, më datën 18.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I.J.D, nga i ati ... dhe nëna ..., e gjinisë ... i lindur me datë ... në ..., me vendbanim në rr “...” numër ... në D..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

II.S.S, nga i ati ... dhe nëna ... e gjinisë ..., i lindur me datë ... në fshatin ... S..., me vendbanim në Lagjen “...” në P..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës.

Në kuptim të nenit 363 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës, të akuzuarit e lartcekur:

LIROHEN NGA AKUZA

Sepse sipas dispozitivit VI pikës III si dhe dispozitivit XIII pika VI

- Në një datë të papërcaktuar të muajit gusht ose shtator të vitit 1998 të akuzuarit e lartcekur, kanë kryer Krime lufte kundër popullatës civile, që parashihet dhe dënohet me Nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ (e që në kohën e ngritjes së aktakuzës ishin penalizuar me Nenet 31 dhe 152 të KPRK), sepse, në kundërshtim me Nenin 3 të Përbashkët dhe Nenin 4 të Protokollit Shtesë II dhe të gjithë rregullat e të drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë aktakuzë, i akuzuari J.D, në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në bashkëkryerje me S.S po ashtu në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një personi të paidentifikuar nga lagja Sh... në M..., i ndaluar në qendrën e ndalimit të L..., duke e rrahu atë në mënyrë të përsëritshme.

-Me këto veprime, të akuzuarit J.D dhe S.S, kishin për të kryer veprën penale: Krime lufte kundër popullatës civile që parashihet dhe dënohet me nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ (që në kohën e ngritjes së aktakuzës penalizohej me nenet 31 dhe 152 të KPRK-së) në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët dhe nenin 4 të Protokollit Shtesa II dhe të gjitha rregullat e të drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur.

Kjo gjykatë konstaton se në kuptim të nenit 363 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale Kodi Nr.08/L-032 tutje (KPPRK-së), nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e cila u vihet në barrë, andaj gjykata të njëjtit i liroj nga akuzat.

-Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Rrjedha e gjithë procedurës sipas aktakuzës PPS.nr.88/11 të datës 06.11.2013

Fillimisht për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, marr për bazë kompleksitetin e rastit e po ashtu edhe volumin që kanë shkresat e lëndës e me qëllim të sqarimit sa më të thjeshtë të kronologjisë se si ka rrjedhë ky rast dhe për tu sqaruar se si përfundimisht objekt i aktakuzës ka mbetur vetëm përshkrimi faktik përkitazi me tani të akuzuarit J.D dhe S.S, kjo gjykatë në radhë të parë në pika të shkurta do të sqaroj gjithë rrjedhën e procedurës së aktakuzës PPS.nr.88/11 të datës 06.11.2013.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS.nr.88/11 të datës 06.11.2013 ndaj gjithsej 15 të pandehurve për Krime lufte kundër popullatës civile.

Në fillimi të procesit gjyqësorë, në kuadër të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, aktakuza me shenjë PPS.nr.88/11 me aktvendimin e Kryetarit të Trupit Gjyqësor të datës 14.04.2014 ishte ndarë në dy lëndë, që të vazhdohet tutje me procedurë të ndara, të emërtuara si “D... I” dhe “D... II”, sipas të njëjtës aktakuzë.

Në kuadër të rastit “D... I” kanë qenë të përfshirë gjithsej gjashtë të pandehur duke përfshirë: J.D, S.B, I.H, S.J, S.L, S.S dhe A.Z.

Në kuadër të rastit “D... II” kanë qenë të përfshirë gjithsej dhjetë të pandehur duke përfshirë A.D,S.S, I.TH, Z.D, F.D, N.D, S.D, D.D, B.D, si dhe J.D për pikat përkatëse të aktakuzës të cilat i përfshinin të pandehurit e lartcekur.

Lidhur me rastin “D... I”, Gjykata Themelore në Mitrovicë me anë të aktgjykimit me shenjën P.nr.938/13 të datës 27.02.2015 kishte shpallur Aktgjykimin ku me atë rast të akuzuarit i kishte gjykuar si në vijim:

I pandehuri S.L është gjetur fajtor për veprën penale në dispozitivin XII pika III dhe i njëjti ishte dënuar me 12 vite burgim.

I pandehuri S.S është gjetur fajtor për veprën penale në dispozitivin XIII pika II dhe i njëjti ishte dënuar me 6 vite burgim.

I pandehuri S.B ishte liruar për veprën penale nga dispozitivit IX pika III.

Të pandehurit J.D dhe S.S janë liruar lidhur me kryerjen e veprës penale në bashkëkryerje, përkatësisht J.D është liruar për dispozitivin VI pika III dhe S.S për dispozitivin XIII pika VI.

I pandehuri S.S është liruar nga dispozitivi XII pika V.

Të pandehurit S.B dhe S.J janë liruar nga akuzat përkatësisht, S.B nga dispozitivi XI pika I, ndërsa S.J nga dispozitivi XI pika IV.

Të pandehurit S.B dhe S.J janë liruar nga akuzat, përkatësisht S.B nga dispozitivi XI pika II dhe S.J nga dispozitivi XI pika II.

I pandehuri I.H është liruar nga akuza përkatësisht nga dispozitivi X pika I.

Të pandehurit S.J, S.L, A.Z dhe S.S janë liruar nga akuza, përkatësisht, S.J nga dispozitivi XI pika I, S.L nga dispozitivi XII pika I, A.Z nga dispozitivi XV pika I, si dhe S.S nga dispozitivi XIII pika I.

I pandehuri S.J është liruar nga akuza përkatësisht nga dispozitivi XI pika III.

Të pandehurit S.J, S.L dhe A.Z janë liruar nga akuzat, përkatësisht S.J për dispozitivin XI pika V, S.L për dispozitivin XII pika II si dhe A.Z për dispozitivin XV pika II.

I pandehuri S.J është liruar nga akuza përkatësisht nga dispozitivi XI pika VI.

Të pandehurit S.J, S.S, dhe S.J janë liruar nga akuza përkatësisht, S.J lirohet nga dispozitivi XI pika VIII, ndërsa S.S lirohet nga dispozitivi XIII pika VII.

I pandehuri A.Z ishte liruar nga akuza përkatësisht nga dispozitivi XV pika II.

Tutje, sipas ankesave lënda është dërguar për vendosje në Gjykatën e Apelit. Duke marrë parasysh se Rasti D... është ndarë në D... I dhe D... II, Gjykata e Apelit ka nxjerrë 2 Aktgjykime dhe atë PAKR.nr.456/15 të datës 14.09.2016, si dhe PAKR.nr.455/15 të datës 15.09.2016.

Gjykata e Apelit me vendimin PAKR.nr.456/15 të datës 14.09.2016 i cili Aktgjykim lidhet me pjesën e II-të të akuzës të ndarë që është emërtuar “D... II”, pasi që Gjykata Themelore në

Mitrovicë kishte nxjerrë Aktgjykimin P.nr.58/14 të datës 27.05.2015 duke vendosur përkitazi me ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve, kjo Gjykatë kishte vendosur si në vijim: duke refuzuar si të pa bazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve I.Th, S.S, Z.D, J.D, A.D, B.D, D.D, S.D, F.D si dhe N.D. Pra me këtë aktgjykim, vendimet e fajshme në pikat I dhe II të aktgjykimit të kundërshtuara konfirmohen dhe në lidhje me të akuzuarit S.S, I.Th, Z.D dhe J.D pikat I dhe II të aktakuzës janë konsideruar pjesë e veprës penale në vazhdim. Po ashtu lidhur me pikën III të Aktgjykimit të shkallës së parë është ndryshuar si në vijim, ku të akuzuarit janë dënuar si në vijim: S.S me 7 vite burgim, I.Th me 6 vite e 6 muaj burgim, Z.D me 6 vite burgim, J.D me 6 vite burgim, ndërsa të akuzuarit A.D, D.D, B.D, S.D, F.D si dhe N.D secili veç e veç janë dënuar me nga 3 vite burgim.

Gjykata e Apelit me vendimin PAKR.nr.455/15 të datës 15.09.2016 i cili Aktgjykim lidhet me pjesën e I-rë të akuzës të ndarë që është emërtuar “D... I” pasi që Gjykata Themelore në Mitrovicë kishte nxjerrë Aktgjykimin P.nr.938/13 të datës 27.05.2015 duke vendosur përkitazi me ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve J.D, S.B, I.H, S.J, S.L, S.S dhe A.Z kishte vendosur si në vijim:

-Lidhur me të akuzuarin S.L, kjo gjykatë të njëjtin e kishte liruar nga vepra penale për dispozitivin XII pika III të aktakuzës pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale, e që me Aktgjykimin e shkallës së parë i njëjti ishte shpallur fajtor dhe ishte gjykuar me 12 vite burgim.

-Lidhur me të akuzuarin S.S kjo gjykatë ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të tij lidhur me pikën e II të aktgjykimit të ankimuar pasi që ajo është pjesë materiale, faktike e veprës penale në vazhdim për të cilën i pandehuri është dënuar më parë dhe në përputhje me rrethanat ankesa aprovohet pjesërisht, ndërsa pjesa tjetër e ankesës është refuzuar si e pa bazë.

-Ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Speciale, është aprovuar pjesërisht dhe në përputhje me rrethanat aktgjykimi i kundërshtuar është ndryshuar në pikën IV si më poshtë :

Të pandehurit J.D dhe S.S janë gjetur fajtor për veprën penale si në vijim “*Gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, në një rast, në mes fillimit të gushtit dhe në fund të shtatorit 1998, duke vepruar si pjesëtarë të UÇK-së dhe në bashkëkryerje me njëri tjetrin, sipas neni 31 të KPRK-së, qëllimisht e kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një mashkulli të paidentifikuar shqiptar nga zona Sh... e M..., i paraburgosur në qendrën e paraburgimit në L... duke e rrahur atë vazhdimisht, në këtë mënyrë, duke u klasifikuar si krim luftime sipas neni 152 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 të KPRK-së dhe në shkelje të neni 4 paragrafi 2 (a) i Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës – në lidhje me Nenin 33, paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”, (ky përshkrim faktik, tani është objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor).*

Në bazë të neni 3 (2) të KPRK-së dhe neni 31 dhe neni 152 paragrafi 1 dhe neni 45 paragrafi 1 i KPRK-së, ata për përshkrimin faktik të lartcekur janë dënuar si në vijim: S.S me 5 vite e 3 muaj burgim, ndërsa J.D me 5 vite burgim.

Sa i përket ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Speciale, që ka të bëjë vetëm me të akuzuarit S.S, S.L dhe S.J, aktgjykimi i kundërshtuar është ndryshuar në pikën IX si në vijim: ku të pandehurit S.S dhe S.L janë gjetur fajtor ndërsa i akuzuari S.J është liruar nga vepra penale për pikën e lartcekur të aktakuzës:

Në bazë të neni 31 dhe neni 152 paragrafi 1 dhe neni 45 paragrafi 1 i KPRK-së, ata janë dënuar si në vijim: S.S me 8 vite burgim, ndërsa S.L me 7 vite burgim.

Gjykata e Apelit duke marrë parasysh dënimet e shqiptuara me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me shenjën PAKR.nr.456/2015 të datës 14.09.2016, të akuzuarve S.S dhe J.D i’u janë shqiptuar dënimet unike si në vijim; të akuzuarit S.S i është shqiptuar dënim unik me burgim prej 10 viteve, ndërsa të akuzuarit J.D i është shqiptuar dënim unik me burgim prej 7 viteve burgim.

Tutje, duke marrë parasysh mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve për goditjen e vendimeve të gjykatës, mbrojtësit e të akuzuarve J.D, S.L si dhe S.S kanë parashtruar ankesat në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.445/15 të datës 15.09.2016. Kjo Gjykatë lidhur me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve kishte vendosur si në vijim: ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.D është refuzuar si e pabazuar. Lidhur me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S.S është aprovuar pjesërisht, ku fillimisht të akuzuarit S.S dhe S.L sa i përket pikës së akuzës IX janë liruar tërësisht, sepse nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale si në pikën IX të akuzës.

Duke marrë parasysh që të akuzuarit janë liruar nga pika IX e akuzës atëherë dënimi për të akuzuarin S.S është modifikuar si në vijim: duke pasur parasysh se i akuzuari S.S është dënuar me 5 vite e 3 muaj burgim për veprën penale siç përshkruhet në pikën IV të aktakuzës dhe më parë është dënuar me 7 vjet burgim me Aktgjykimin PAKR.nr.456/15 të Gjykatës së Apelit të datës 14.09.2016, të akuzuarit S.S i është shqiptuar dënim i përgjithshëm prej 8 viteve burgim. Ndërsa sa i përket të akuzuarit S.L duke pasur parasysh se i njëjti me këtë vendim është liruar nga pika e IX e aktakuzës paraburgimi i është pushuar dhe i njëjti është urdhëruar të lirohet menjëherë.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.S i pa kënaqur me vendimet paraprake të gjykatave, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PA II 11/2016 të datës 03.07.2017, Aktgjykimit PAKR.nr.455/15 të Gjykatës së Apelit të datës 15.09.2016 si dhe ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicës me shenjën P.nr.938/13 të datës 27.05.2015. Lidhur me pretendimet e mbrojtjes, Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktgjykimin me numër PML.KZZ.nr.233/2017 të datës 11.06.2018 me anë të së cilës ka vendosur si në vijim: duke aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së mbrojtësit të akuzuarit S.S për pjesën që ka të bëjë me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore në Mitrovicë për arsye se trupi gjykues i cili ka nxjerrë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë me shenjën P.nr.938/13 të datës 27.05.2015 ka qenë në kundërshtim me ligjet Nr.03/L-053 dhe Nr.04/L-273. Këto shkelje sa i përket trupit gjykues kanë të bëjnë me faktin se kolegji në atë kohë ka vërtetuar se ky rast është përkufizuar “në proces” sipas përkufizimit që është ofruar në nenin 1 A të Ligjit Nr.03/L-053 për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EX-it, të ndryshuar nga ligjet Nr.04/L-273 dhe Nr.05/L-103 dhe se me vendimet e datave 16 nëntor dhe 17 dhjetor 2017, Këshilli Gjyqësorë i Kosovës kishte vendosur që kolegji të përbëhet nga një shumicë e gjyqtarëve vendorë dhe një gjyqtar vendor si kryetar i kolegjit, andaj ka anuluar të gjitha Aktgjykimet e marra më herët dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

Për të sqaruar më tej, pika e aktakuzës e cila rezultonte të jetë kthyer në ri-gjykim sipas Aktgjykimin me numër PML.KZZ.nr.233/2017 të datës 11.06.2018 është dispozitivi **VI pika III për të akuzuarin J.D si dhe dispozitivi XIII pika VI për të të akuzuarin S.S** (por që të njëjtat pika janë identike, veç se në kohën kur është ngritur aktakuza përshkrimet faktike janë ndarë në pika të veçanta për secilin të akuzuar veç e veç, por kemi të bëjmë me të njëjtin përshkrim faktik – të njëjtin pretendim të prokurorisë.

Përpos rrjedhës së procedurës të cilën e kemi sqaruar në pika të detajuara më lartë se si çështja për të akuzuarin S.S ka ardhur deri në rigjykim (vetëm për pikën e lartshënuar të aktakuzës), në vazhdim do të shpjegohet në mënyrë të detajuar se mbi çfarë baze çështja penale është kthyer në rigjykim edhe për të akuzuarin J.D, respektivisht për të sqaruar se ankesat për pikat e tjera të aktakuzës ishin refuzuar, dhe së fundi edhe ndaj të njëjtit e vetmja pikë e aktakuzës që kishte mbetur për rigjykim ishte pika e lartshënuar e aktakuzës.

Së pari vlen të ceket se mbrojtësit e të të akuzuarve A.D, S.S, I.Th, Z.D, F.D, N.D, S.D, D.D, B.D, duke përfshirë edhe mbrojtësin e të akuzuarit J.D kanë paraqitur në Gjykatën Supreme kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë të datës 27.05.2015 me shenjën P.nr.58/14 si dhe ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 14.09.2016 me shenjën PAKR.nr.456/15, ku me këtë rast Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktgjykimin me shenjën PMK.KZZ.nr.322/2016 të datës 19.07.2017 ku me këtë rast ka refuzuar të gjitha kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga mbrojtësit e të të akuzuarve duke përfshirë edhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nga ana e të akuzuarit J.D ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë të datës 27.05.2015 me shenjën P.nr.58/14 si dhe ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 14.09.2016 me shenjën PAKR.nr.456/15.

Tutje mbrojtësit e të të akuzuarve I.TH, Z.D, F.D, N.D dhe J.D kanë ushtruar kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me kontestimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.KZZ.nr.322/2016 të datës 19.07.2017 që ka të bëjë me atë se Gjykata Supreme e Kosovës nuk e ka trajtuar si duhet çështjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore në Mitrovicë pasi që kjo përbërje ishte caktuar në kundërshtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve të EX-it në trupat gjykues, me ç'rast u është cenuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe pretendimet e tyre lidhur me dëshmitarët të cilët janë dëgjuar në këtë proces, (bëhet fjalë për rastin D... II).

Gjykata Kushtetuese në këtë rast ka trajtuar kërkesat e paraqitura nga ana e mbrojtësve të të akuzuarve të lartcekur dhe e njëjta ka konstatuar se Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Pml.KZZ.nr.322/2016 të datës 19.07.2017 ka dështuar të jap një vlerësim dhe arsyetim të plotë lidhur me atë se a ka qenë caktimi i gjyqtarëve në trupin gjykues në rastin e parashtruesve në Gjykatën Themelore në pajtim me tërësinë e dispozitave ligjore të zbatueshme, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml.KZZ.nr.322/2016 të datës 19.07.2017 dhe me këtë rast është shkëlur e drejta e parashtruesve për një vendim të arsyetuar dhe me këtë ka shkëlur të drejtën e parashtruesve për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, ku me këtë rast Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të lartcekur e ka shpall të pavlefshëm dhe të njëjtin e ka kthyer për rishqyrtim.

Me rastin e kthimit të çështjes në rishqyrtim Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin Pml.nr.158/2018 të datës 26.09.2018 ku me këtë rast edhe njëherë ka refuzuar kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të të akuzuarve A.D, S.S, I.TH, Z.D, F.D, N.D, S.D, D.D, B.D, J.D me arsyetimin se burimet në të cilat thirren paraqitësit e kërkesës janë të pasigurta, sepse bëhet fjalë për informatat të marra nga mjetet e informimit dhe emailat anonime, të dërguara në kopje, ndërsa gjykata e bazon vendimin e vetë në prova që janë nxjerr sipas rregullave të ligjit procedural, të cilat janë të besueshme dhe të përshtatshme për vërtetimin e një fakti relevant, të vlerësuar edhe në lidhje me provat tjera, dhe në arsyetimin e këtij vendimi ka shtuar se pretendimi që ndërlidhet me vërtetimin e fakteve (konkretisht të faktit se a ka pas veprime jo ligjore në përcaktimin e anëtarit të trupit gjykues), vlerësim i të cilave, konform dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK-së, nuk mund të ngritën me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik.

Pasi që Gjykata Supreme kishte vendosur çështjen e kthyer në rishqyrtim, mbrojtësit e të të akuzuarve Z.D, J.D, F.D, N.D, I.TH, B.D, S.D, D.D dhe A.D kishin paraqitur në Gjykatën Kushtetuese kërkesë lidhur me kontestimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.158/2018 të datës 26.09.2018 lidhur me shkëljen e të drejtave të parashtruesve të kërkesës si dhe kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme përkatësisht ndalimit të ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka adresuar pretendimet e

parashtruesve të kërkesës me rastin e caktimit të trupit gjykues të Gjykatës Themelore dhe rrjedhimisht ka vlerësuar se pretendimet e tilla janë të pabazuar në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet refuzuar si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të rregullores së punës.

Duke marrë parasysh rrjedhën e procedurës deri më tani, nënkuptohet fakti se Rasti D.. I dhe D.. II për të gjitha pikat e aktakuzës është mbyllur deri në Gjykatën Kushtetuese. Përjashtim nga rastet e lartcekura të mbyllura bëjnë vetëm **dispozitivi VI pika III si dhe dispozitivi XIII pika VI** e aktakuzë së lartcekur me të cilët dispozitiv ngarkohen të akuzuarit J.D e S.S, e kjo për faktin se këtë përshkrim faktik të aktakuzës e kishte anuluar Gjykata Supreme me Aktgjykimin PML.KZZ.nr.233/2017 të datës 11.06.2018 sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit S.S, Avokatit Gregor D. Guy Smith, me ç’rast, rasti është kthyer në rigjykim. Sa i përket të akuzuarin J.D, e me rastin e kthimit të çështjes në rigjykim për të akuzuarin S.S, është proceduar në mënyrë të njëjtë edhe për të akuzuarin J.D, duke marrë parasysh faktin se të akuzuarit J.D dhe S.S akuzohen për të njëjtin përshkrim faktik se kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje dhe kështu duke respektuar parimin “Beneficium Cohesionin”, Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe Prokuroria Speciale me të filluar trajtimin e rastit në ri-gjykim kanë proceduar me tani dy të akuzuarit, atëherë kjo gjykatë ka vazhduar në mënyrë të njëjtë procedurën për të njëjtit.

Për sqarim përfundimtar, nga e gjithë aktakuza me numër PPS.nr.88/11 e datës 6 Nëntor 2013, tani në shqyrtimin gjyqësor që ka proceduar gjykata, objekt shqyrtimi ka mbetur për të akuzuarin J.D **dispozitivi VI pika III e aktakuzës** dhe për të akuzuarin S.S **dispozitivi XIII pika VI** e aktakuzës së lartshënuar, por për sqarimin, kemi të bëjmë me të njëjtin përshkrim faktik dhe cilësim juridik, veçse në atë kohë aktakuza për secilin të akuzuar ishte ndarë dispozitivët veç e veç ani se ato janë përsëritur. Andaj në shqyrtimin gjyqësor që ka proceduar gjykata, objekt i këtij shqyrtimi ishte vetëm përshkrimi faktik i lartcekur, ndërsa për të gjithë të akuzuarit e tjerë të përfshirë në këtë aktakuzë, aktgjykimet kanë marrë formën e prerë dhe rastet janë mbyllur.

Rrjedha procedurës pasi që rasti është kthyer në ri-gjykim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, pasi që lënda është kthyer në rigjykim, më datën 26.12.2019 ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësorë, por shqyrtimi nuk është mbajtur për arsye se prokurorja e rastit kishte kërkuar që seanca të shtyhet për shkaqe të kohës së shkurtër që do të pamundësonte sigurimin e dëshmitarit A në procedurë. Po ashtu kjo gjykatë kishte caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësorë më datën 25.03.2020 e cila po ashtu është shtyer për shkak të mos krijimit të kushteve të sigurimit të dëshmitarit A e ku prokurorja e rastit kishte njoftuar se polici përgjegjës për sigurimin e të njëjtit ka thënë se për shkak të anulimit të fluturimeve është e pamundur të sigurohet prezenca e tij. Tutje, gjykata kishte caktuar më datën 07.12.2020 seancën e shqyrtimit gjyqësorë por e cila nuk është mbajtur për shkak se anëtarët e trupit gjykues kanë qenë të infektuar me virusin COVID-19, e që nga ajo kohë asnjëherë nuk është caktuar ndonjë seancë lidhur me rastin D... I (rastin e kthyer në rigjykim).

Me rastin e dërgimit të lëndës nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, tek Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, kjo gjykatë fillimisht sqaron se, sa i përket kompetencës territoriale, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykata me Nr.06/L-054 në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, vepron Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Tutje, Vepra penale të Krimeve të Luftës hyjnë në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës sipas Ligjit për Prokurorinë Speciale Ligji Nr.08/L-168, andaj duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykata, kjo gjykatë ka vazhduar me trajtimin e rastit.

Gjykata sërish vë në dukje se ka përfillur rekomandimet Gjykatës Supreme me anë të Aktgjykimit me numër PML.KZZ.nr.233/2017 të datës 11.06.2018, ku e njëjta kishte konstatuar se përbërja e trupit gjykues në Shkallën e I-rë aso kohe nuk ka qenë në përbërje të rregullt, andaj kjo gjykatë kishte konstatuar se tani e tutje trupi gjykues ishte në përbërje të rregullt nga tre gjyqtarë të Departamentit Special.

Shqyrtimi gjyqësor-pranë Departamentit-Special

Siç u sqarua gjatë rrjedhës së kronologjisë së këtij rasti, kjo gjykatë këtë lëndë e ka trashëguar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë. Me të pranuar rastin e pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, menjëherë me datën 12.04.2024 është proceduar me shqyrtimin gjyqësor.

Duke pasur parasysh faktin se me rastin e procedimit të këtij rasti pranë Departamentit Special, çështja ishte proceduar para një trupi tjetër gjykues, kjo çështje penale në kuptim të nenit 311 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale ka filluar rishtazi.

Në këtë seancë gjyqësore, të akuzuarve J.D dhe S.S i është dhënë mundësia që të deklarohen lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tyre për veprën penale e cilat i'u vihet në barrë.

Të akuzuarit e lartcekur ishin deklaruar të pafajshëm, lidhur me veprën penale për të cilën akuzohen.

Gjykata pasi që ka konstatuar se të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale, përkatësisht për dispozitivin VI pika III si dhe dispozitivin XIII pika VI të aktakuzës, është vazhduar me fjalën hyrëse të palëve.

Fjala hyrëse e palëve

Prokurorja Speciale, në fjalën hyrëse ishte deklaruar si vijon: Aktgjykimi i lëshuar në rastin P.nr.938/13 i njohur si Drenica I, është një gurthemel i sistemit gjyqësorë në Kosovë, ku ndër gjetjet e tjera është specifikuar se S.S ka torturuar dëshmitarin A. Nga kronologjia e vendimeve gjyqësore rasti në fjalë rezulton se tani objekt i rigjykimit është vepra penale kundër J.D nga pika 6 paragrafi 3 dhe kundër S.S nga pika 13 paragrafi 6 i aktakuzës. Tutje ka theksuar se Prokuroria ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës në rastin konkret dhe ka ardh në përfundim se si dëshmitar në këtë çështje do të dëgjohet vetëm dëshmitari A dhe se në bazë të kësaj dëshmie trupi gjykues do të bindet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen. Sipas dispozitivit të kësaj aktakuze, të akuzuarit ngarkohen se si pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë cenuar integritetin trupor të një personi të pidentifikuar dhe atë në L... Sh... të M..., e ku dëshmitari A është dëgjuar në disa faza të procedurës dhe dëshmitë e tij kanë qenë të njëjta sa herë që i njëjti ka dhënë deklaratat, ndër të tjera ai ka deklaruar se më datën 15.08.1998 është marrë nga UÇK dhe se dëshmia e tij është konstatuar e besueshme dhe nuk ka përmbajtur ndonjë elemente që do të kundërshtojë nga njohurit e përgjithshme dhe në përgjithësi dëshmia e tij është e qëndrueshme dhe e besueshme për Prokurorin, e ndër të tjera ka theksuar se dëshmitë e tij nuk kanë pasur mospërputhje në kallëzimin e tij edhe pse dëshmitari vazhdimisht është pyetur për çështjet e njëjta. Lidhur me dëshmitarin A prokurorja në fjalën hyrëse ka shtuar se ky dëshmitar i ka njohur mirë tani të akuzuarit e cila vërtetohet edhe nga dëshmia e tij që ka treguar se si është dërguar në L... ditën e shtunë dhe atë më datën 15.08.1998, e tutje ku ky dëshmitarë është dëgjuar edhe përgjatë seancave gjyqësore nga ana e trupit gjykues. Sa i përket këtij

dëshmitari e njëjta ka theksuar se lidhur me këtë dëshmitar ekziston edhe dokumenti se i njëjti gëzon statusin e veteranit i cili dokument është nxjerrë sipas detyrës zyrtare nga gjykata. Dëshmitari A përgjatë intervistimit të tij por edhe deklaratimit para trupit gjykues ka theksuar se si më datën 15 gusht 1998 dy ushtarë të UÇK-së kanë ardhur me një automjet tereni në shtëpinë e dëshmitari A ku e kanë parkuar automjetin afër derës dhe kanë hyrë në oborr ku kanë pasur uniforma të kamufluara të UÇK-së dhe pushkë e revole, ku të njëjtit ishin prezantuar si polic ushtarak dhe kanë urdhëruar dëshmitarin A të shkonte me ata duke thënë se kishin urdhër nga S.S për ta qar në L... dhe aty duhet të jepte deklaratë dhe dëshmitari A u ishte bindur urdhrave dhe pastaj të njëjtin e kanë pyetur dëshmitarin se a e din ku kishte shtëpinë dëshmitari B.

Për fund ka shtuar se Prokuroria ka analizuar të gjitha dëshmitë e dëshmitarit A të dhëna si në procedurën hetimore por edhe në shqyrtimet kryesore dhe pas analizimit të të gjitha dëshmimeve ka ardhur në përfundim se trupi gjykues pas dëgjimit të këtij dëshmitari do të bindet se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen dhe të njëjtit t'i shpallin fajtorë dhe t'i dënojnë me dënim sipas ligjit.

Avokat Mexhid Syla në fjalën hyrëse ishte deklaruar si vijon: i mbrojturi i tij J.D si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, akuzohet se në bashkëkryerje me S.S ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një personi të pidentifikuar nga L... Sh... në M... dhe atë duke e rrahur në mënyrë të përsëritshme. I njëjti ka shtuar se unë nuk i kontestoj faktet se në periudhën kohore të paraqitur në Aktakuzë në Kosovë ka ekzistuar konflikti i armatosur i brendshëm në mes të UÇK-së dhe forcave ushtarako-policore dhe paramilitare të Serbe, përkundrazi J.D ashtu si krejt pjesëtarët e UÇK-së krenohet me kontributin që e ka dhënë për çlirimin e vendit dhe mbrojtjen e popullsisë civile nga dhuna dhe terrori që ushtrohej mbi të nga regjimi serb. Lidhur me paraqitjet e deritanishme ka theksuar se këtë çështje e ka kundërshtuar aktakuzën për të gjitha pikat me konstatim se gjatë rrjedhës së procedurës dhe administrimit të pronave do të bindet trupi gjykues se i mbrojturi i tij nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe nuk e ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e asnjë personi dhe nuk ka marrë pjesë në rrahjet ashtu si gabimisht pretendon akuza dhe prokurori i çështjes në fjalën hyrëse.

Në fjalën e tij hyrëse ka theksuar se gjatë zbatimit të procedurës dhe pas administrimit të provave do të bindeni se akuza publike nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për t'i ofruar gjykatës prova të cilat vërtetojnë fakte dhe rrethana me rëndësi se J.D ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, në fakt akuza është e bazuar vetëm në dëshminë e dëshmitarit A, ku pas vlerësimit të kësaj prove do të bindeni se edhe nga kjo dëshmi nuk do të vërtetohet asnjë rrethanë me rëndësi që e mbështet dyshimin e bazuar se J.D ka kryer këtë vepër penale. Tutje ka shtuar se në këtë aktakuzë nuk është përcaktuar me saktësi koha e kryerjes së veprës penale ku në dispozitiv thuhet “mes fillimit të Gushtit dhe në fund të Shtatorit të vitit 1998”, e po ashtu nuk dihet objekti ndaj të cilin është kryer vepra penale, pra nuk dihet personi të cili i është cenuar integriteti trupor dhe shëndeti ku në aktakuzë thuhet “një personi të pidentifikuar nga L... Sh... të M...”, tutje nuk dihet as mjeti me të cilin është kryer vepra penale si dhe rrethanat tjera të nevojshme me rëndësi për tu përcaktuar me saktësi kryerja e kësaj vepra penale. Fillimisht si është shkalla e cenimit të integritetit dhe shëndetit trupor, eventualisht nëse ka pas ndonjë lëndim për tu vlerësuar nga ana e gjykatës se a mund të trajtohen ato si veprime që paraqesin figurën e veprës penale krime lufte kundër popullsisë civile ashtu si është akuzuar J.D.

Sa i përket deklaratave të dëshmitarit A lidhur me këtë pikë të akuzës thotë vetëm këtë “ata janë mbajtur për 2 netë është fjala për vëllezërit nga Sh... i M..., të cilët nuk dihet se kush janë”, dhe S.S dhe J.D kanë rrahur njërin prej atyre aty në dhomën time, ku nga kjo pjesë e deklaratës së këtij dëshmitari A, çka saktësisht mund të vërtetohet, e ndërsa përfaqësuesi i akuzës ku e mbështet konstatimin në dispozitivin e aktakuzës ku thotë “duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritshme” e që në këtë pjesë akuza del të jetë në kundërshtim të plotë me provën kryesore që bazohet e që kjo njëherit paraqet shkelje të dispozitave të procedurës penale e cila dispozitë

pjesëmarrësit në procedurë që të gjitha provat t'i vlerësoj në mënyrë të plotë dhe të drejtë në favor dhe ato që janë kundër të akuzuarit. Duke pasur parasysh të gjitha kto rrethana i njëjti ka shtuar se do të gjeni se kemi të bëjmë me provë të pabesueshme të paraqitur nga një dëshmitar jokredibil, te i cili manifestohet një tendencë për të rënduar pozitën penalo-juridike të të mbrojturit të tij e edhe të tjerëve për arsytet të cilat vetëm ai duhet t'i dij, po ashtu ka shtuar se kemi të bëjmë me dëshmitar jokredibil në shkresat e lëndës ku ka prova të shumta të cilat në të gjitha fazat e procedurës deri më tani janë prezantuar nga mbrojtja por të cilat janë refuzuar. Andaj në fund ka shtuar se vlerësoj se gjykata nuk do ta shpall fajtor asnjë person e në këtë rast të mbrojturin e tij në bazë të një dëshmie të një dëshmitari të mbrojtur, dëshmia e të cilit si u tha më parë nuk vërteton asnjë rrethanë me rëndësi se J.D ka kryer veprën penale ashtu si e ngarkon akuza, ka kërkuar nga prokurori që edhe në këtë fazë të procedurës të reflektojë në atë mënyrë që të heq dorë nga aktakuza, në të kundërtën ka kërkuar nga trupi gjykues që të mbrojturin e tij ta shpall të pafajshëm në mungesë të provave.

I akuzuari J.D në fjalën hyrëse ishte deklaruar si vijon: e mbështes fjalën hyrëse të avokatit tim, dhe nuk kam diçka tjetër për të shtuar.

Avokat Artan Qerkini në fjalën hyrëse ishte deklaruar si vijon: në këtë shqyrtim gjyqësorë do të shihni se dëshmia e dëshmitarit në të cilën mbështetet akuza e lartcekur është e pa besueshme dhe se nuk mbështetet në asnjë provë tjetër materiale apo në ndonjë dëshmi të dëshmitarëve të tjerë.

Lidhur me dëshminë e dëshmitarit A i njëjti ka shtuar se dëshmitari A në dëshminë e tij thotë se 3 vëllezër nga Sh... i M... janë ndaluar nga UÇK-ja se i kanë shitur dele serbëve, ku kjo deklaratë nuk është në përputhje me realitetin objektiv të asaj kohe, kur dihet se UÇK-ja në atë periudhë kohore është ballafaquar me ofensiva të mëdha të forcave serbe të cilat kane qenë shumëfish më të forta në aspekti ushtarak dhe prandaj pretendimi se S.S duke qenë në atë kohë pjesë e shtabit të përgjithshëm është marrë me faktin se kush kujt po i shet dele është më shumë se absurd.

Përveç argumenteve të mësipërme i njëjti ka theksuar se sipas pretendimeve të praktikës gjyqësore në asnjë rrethanë nuk mund të vërtetohet një fakt penal me dëgjimin e vetëm një dëshmitari, sepse pa prova tjera të cilat mbështesin deklaratën e dëshmitarit gjykata nuk mund të arrij standardin “përtej dyshimit të arsyeshëm” plotësim i të cilit është i domosdoshëm në mënyrë që gjykata të ketë mundësi ligjore të jap një aktgjykim dënues. Lidhur me praktikën gjyqësore i njëjti ka shtuar se, Gjykata Themelore në Prishtinë, paneli i përbërë prej gjyqtarëve të EX-it në rastin penal P.425/11, fq 92 kishte konstatuar se; *“si rezultat, edhe në rast se dëshmia e AZ nuk do të ishte përjashtuar, trupi gjykues do të ishte kufizuar në përcaktimin e fajësisë në bazë të dëshmisë së një dëshmitari të vetëm”*. Përpos kësaj edhe Tribunali për ish Jugosllavi në rastin penal IT-96-21-T të datës 16.11.1998, Rasti i njohur si “Q...” në paragrafin 988 mban qëndrim se dëshmia e vetëm një dëshmitari nuk e plotëson standardin “përtej dyshimit të bazuar” standard ky i nevojshëm për një aktgjykim dënues. Po ashtu i njëjti në fjalën hyrëse të tij ka shtuar se edhe vetë faktet materiale të prezantuara në pikën 6 të aktit akuzues në vet vete nuk përbëjnë shkelje të rëndë të Nenit 4 par 2 (a) të Protokollit 2 të Konventave të Gjenevës, përkatësisht në rastin S.H në faqen 11 të Aktgjykimit Tribunali për ish Jugosllavi kishte konstatuar se do të ekzistojë kompetenca lëndore e këtij Tribunali për shkak të shkeljes së të drejtës humanitare të cilat nuk janë të përfshira në nenet 2,4, dhe 5 të Statutit me ç’rast duhet të plotësohen kushtet në vijim: a) duhet të ekzistojë një shkelje e të drejtës humanitare, b) ajo shkelje duhet të konsiderohet shkelje e të drejtës zakonore ndërkombëtare si dhe c) ajo shkelje duhet të jetë e rëndë, përkatësisht duhet të konsistojë në shkeljen e ndonjë rregulli i cili mbron vlera të rëndësishme, ndërsa vet shkelja duhet të shkaktojë pasoja të rënda për viktimën.

Tutje ka shtuar se Paneli i Apelit të Tribunalit për ish Jugosllavi, në rastin T. ka sqaruar se “shkelje e rëndë” nënkupton shkeljen e rregullave me të cilat mbrohen të mirat e rëndësishme, dhe kjo shkelje duhet të inkorporoj në vete pasoja të rënda për viktimën.

Në bazë të pretendimeve të sipërshënuara, në fund ka kërkuar nga trupi gjykues që në këtë çështje penale, pasi që mungojnë provat për një aktgjykim dënues dhe vepra e përshkruar në pikan VI të aktakuzës nuk paraqet vepër penale, kërkojnë Aktgjykim lirues për të akuzuarit S.S dhe J.D.

I akuzuari S.S në fjalën hyrëse ishte deklaruar si vijon: e mbështesë fjalën hyrëse të avokatit tim, po ashtu dua të shtoj se qoftë atëherë kur jam akuzuar dhe qoftë sot un nuk e kam të kjtartë se kënd e paskam rrahur, kënd e kam malltretuar dhe kush janë këta njerëz.

Kjo gjykatë specifikon faktin se, përgjatë fjalës hyrëse të Avokatit Artan Qerkini njëherit mbrojtës i të akuzuarit S.S, i njëjti kishte propozuar që deklaratat e dëshmitarit “A” të dhëna në kuadër të kësaj procedure penale të konsiderohen të lexuara.

Lidhur me propozimin e lartcekur, fillimisht gjykata ka marr mendimin e palëve të tjera në procedure.

Prokurorja Speciale është pajtuar me leximin e deklaratave të dëshmitarit “A” duke theksuar se: meqenëse avokati dha një propozim të tillë, që dëshmitari “A” të mos të ftohet dhe të dëgjohen në seancë për shkak se i njëjti është dëgjuar disa herë, un si prokurorë i kam analizuar dëshminë e këtij dëshmitari të dhëna si në procedurën hetimore ashtu edhe në procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore, dhe kjo dëshmi e dëshmitarit shkon në favorin e prokurorisë dhe meqenëse këtij dëshmitari i është dhënë mundësia që të merret në pyetje si nga prokurori ashtu edhe nga pala mbrojtëse- avokatët, në rastin konkret mendoj se janë përmbushur të gjitha kriteret dhe nuk e kundërshtoj- jap pëlqimin që deklaratat e këtij dëshmitari të dhëna më parë në procedurë të lexohen si dëshmi të rregullt.

Po ashtu edhe Avokati Mexhid Sylja mbrojtës i të akuzuarit J.D është pajtuar me propozimin e Avokatit Qerkini si dhe njëkohësisht edhe të akuzuarit S.S dhe J.D janë pajtuar lidhur me propozimin e lartcekur.

Kryetari i trupit gjykues para se trupi gjykues të tërhiqej për vendosje, kishte pyetur edhe njëherë palët në procedurë qe po që se dëshmitari do te sigurohet, a do të kishin ndonjë pyetje shtesë për dëshmitarin që nuk është bërë në stade të mëparshme të procedurës, apo konsideroni që janë shterur të gjitha pyetjet, i keni marr të gjitha përgjigjet, andaj edhe prania e tij do të ishte humbje kohe për procedurën.

Të gjitha palët në procedurë ishin deklaruar se edhe sikurse të sigurohej prezenca e dëshmitarit A, nuk do të kishin asnjë pyetje për të njëjtin në seancë gjyqësore pasi që i kanë shterur të gjitha pyetjet dhe kanë marrë të gjitha sqarimet.

Nga rrethanat e lartcekura, trupi gjykues kishte marr aktvendim dhe kishte vendosur që të lexohen Deklarata e dëshmitarit “A” e dhënë në Prokurori më datën 13.12.2011, si dhe Deklaratat e dëshmitarit “A” të dhëna në seancat e shqyrtimit gjyqësorë të mbajtura më datat 25.06.2014, 17.07.2014, 18.07.2014.

Kjo gjykatë më tej sqaron se janë lexuar vetëm deklaratat e dëshmitarit të dhëna përkitazi me objektin e aktakuzës që tani është objekt shqyrtimi dhe jo edhe deklaratat kur i njëjti ka deklaruar për rastet që tani veç se kanë marrë formën e prerë.

Trupi gjykues me rastin e marrjes së këtij aktvendimi, ka vlerësuar se dëshmitari kishte dhënë disa herë deklaratë përkitazi me këtë çështje dhe se marr për bazë kohën që ka kaluar nga dhënia

e deklaratave të tij, paraprakisht nga Prokuroria Speciale dhe Gjykata Themelore Mitrovicë është hasë në vështirësi sigurimi i të njëjtit, andaj ideja për sigurim të domosdoshëm të tij do të qonte edhe në zvarritje të procedurës. Tutje trupi gjykues ka vlerësuar po ashtu se fakti që palët kanë deklaruar se nuk do të kishin asnjë pyetje të vetme për të njëjtin, prezenca e tij nuk do të bënte ndryshimin, për faktin se të gjitha pyetjet i janë bërë dëshmitarit përkritazi me këtë çështje dhe se po ashtu deklaratimet e tij kanë qenë nën betim dhe se në këto rrethana trupi gjykues ka vlerësuar se janë përmbushur kriteret ligjore të përcaktuara me nenin 307 paragrafi 3 dhe nenin 335 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 të KPPRK-së, andaj edhe këtë propozim e aprovoi.

Procedimi i provave personale

Siç u specifikua më sipër, Gjykata në vazhdimin e shqyrtimit gjyqësorë të mbajtur më datën 12.04.2024 kishte lexuar deklaratat e dëshmitarit “A” si në vijim: deklarata e dhënë në Prokurori më datën 13.11.2011 si dhe Deklaratat e dhëna në seancat e shqyrtimit gjyqësorë të mbajtura më datat 25.06.2014, 17.07.2014, 18.07.2014.

Siç u sqarua më sipër dhe për të mos krijuar huti me rastin e arsyetimit të këtij aktgjykimi marr parasysh kompleksitetin dhe volumin e rastit si tërësi e aktakuzës së lartcekur, vlen të theksohet se dëshmitari “A” në kuadër të procesit gjyqësorë të mëparshëm i cili është zhvilluar në kuadër të Gjykatës Themelore në Mitrovicë është dëgjuar disa herë përgjatë shqyrtimeve gjyqësore, por në kuadër të administrimit të provave personale në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë lexuar vetëm deklaratat të cilat kanë pasur relevancë me objektin e akuzës –pjesën e mbetur të aktakuzës – objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor (dispozitivi VI pikës III si dhe dispozitivi XIII pika VI e aktakuzës.)

Deklaratat e dëshmitarit “A”

Fillimisht, ashtu siç është specifikuar edhe në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, edhe njëherë ritheksojmë faktin se dëshmitari A për gjatë shqyrtimeve gjyqësore për të gjitha pikat e aktakuzës ka dhënë shumë deklarata, por kjo gjykatë do të lëshohet vetëm në fragmentet që janë të lidhura me objektin e aktakuzës që ka të bëjë me këtë shqyrtim gjyqësor ashtu siç edhe është elaboruar më herët për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Në cilësi të dëshmitarit në deklaratimet e tij të dhëna i njëjti ka deklaruar si në vijim:

-Në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori më datën 13.12.2011 lidhur me objektin e akuzës kur është pyetur ishte deklaruar se: i kujtohen tre vëllezër nga Sh..., zona e M... të cilët ishin sjellë në dhomën e burgut të L... ku ai kishte qëndruar, sepse gjoja ata kishin shitur disa dele serbëve. I njëjti ka shtuar se ata kanë qëndruar aty për dy netë, ku të akuzuarit S.S dhe J.D kishin rrahur njërin prej atyre në dhomën e tij përgjatë ditës. Pastaj i kanë vendosur edhe jashtë në korridor dhe se të njëjtit kishin dëgjuar disa të bërtitura, ai thekson se kjo ishte në periudhën kur H., F. dhe G. ishin me të në dhomë, sa i përket emrave të këtyre tre vëllezërve ka shtuar se nuk i din, por i kujtohet se ata kishin edhe gjashtë vëllezër në familjen e këtyre.

Në deklaratat e tij të dhëna në kuadër të shqyrtimeve gjyqësore dëshmitari “A” kishte deklaruar:

-Në seancën e datës 25.06.2014 lidhur me objektin e akuzës i njëjti kishte deklaruar si në vijim: Lidhur me personat që kanë qenë të pranishëm në qelinë e tij ka deklaruar se me sa e din ai kanë qenë 3 vëllezër nga mahalla e Sh... në M..., ata kanë qëndruar 2-3 orë me atë atje dhe e shanin UÇK-së. Ai ka shtuar se në ditën tjetër S.S ka ardhur tek dhoma ku kanë qëndruar dhe se ata i

kanë shitur qingjat e tyre dhe i kanë pyetur “*pse nuk na i ke dhënë ata qingja neve por i ke shtiru tek serbët*”, ku ka shtuar se ata në një mënyrë apo tjetër ata po shanin UÇK-në dhe se ditën tjetër J.D ka ardhur në dhomë dhe e kanë rrahu njërin nga të tre vëllezërit në prezencën e tij. Lidhur me të akuzuarin S.S në pyetjen se a mos i ka rrahur ai ndonjë herë vëllezërit, i njëjti është përgjigjur se, “*po, J.D, ka rrahur një nga ata por gjithashtu edhe S.S. Ka shtuar se ai nuk ka guxuar që t’i priste ata të ulur sepse që të tregonin vetveten ata thonin se shikoni çfarë po ju bëjmë atyre, të njëjtën gjë do ta bëjmë edhe ty*”. Lidhur me kohën e rrahjes së këtyre vëllezërve i njëjti ka shtuar se ata i kanë rrahur gjatë ditës, dhe se i akuzuari S.S ka rrahur vetëm njërin nga vëllezërit, ku njërin prej vëllezërve e kanë rrahur me rradhë njëri këtë herë dhe tjetri herën tjetër duke e shqelmuar dhe me grushta, dhe në momentin kur ai lodhej ai zëvendësohej nga J.... Në pyetjet e kryetarit të trupit gjykues lidhur me atë se a ka ushtruar ndonjë formë veprimi dhune përveç grushtimit S.S, ai është përgjigjur se ata e kanë rrahur atë për 10 minuta në dhomën e tij dhe pastaj e kanë nxjerrë jashtë saj dhe kanë bërë titur, lidhur me mënyrën e rrahjes ka shtuar se vetëm me grushta dhe shqelma e kanë rrahur dhe se e kanë rrahur sa ishte në këmbë pa u rrëzuar në tokë. Po ashtu lidhur me atë se a e ka fjalën për të njëjtin vëlla që është rrahur nga J.D dhe S.S, i njëjti ka deklaruar se ishte i njëjti vëlla që është rrahur, sepse ai pretendonte të ishte budalla dhe po shante UÇK-në. Kur është pyetur nga prokurori i shtetit lidhur me atë se gjatë rrahjes së këtij vëllau a ishte edhe F.M, G.V dhe H.M të pranishëm, i njëjti është përgjigjur “*vetëm unë dhe G. V*”, tutje ai nga prokurori është pyetur edhe një herë se sa vëllezër janë rrahur, pasi që para pak minutash gjatë deklarimit ai ka deklaruar se dy vëllezër nga Sh... ishin rrahu dhe para një momenti i njëjti ka deklaruar se vetëm një vëlla është rrahur, i njëjti ka deklaruar si në vijim “*unë thashë se të tre vëllezërit janë sjellë në dhomën time, e thashë dhe po e them edhe njëherë tjetër se vetëm njëri nga vëllezërit është rrahur në prezencën time, sepse ai po shante UÇK-në dhe pretendonte të ishte budalla*”.

Dëshmitari A në seancën e datës 17.07.2014 në pyetjet e Avokati mbrojtës të të akuzuarit J.D, avokat Mexhit Sylja ishte deklaruar si në vijim: në pyetjen lidhur me deklarinimin e tij në prokurori si dhe gjatë deklarimit të tij në seancën e fundit ku i është referuar njerëzve që ishin të kapur me të, si G.V, mësuasi nga P..., plaku 80 vjeq dhe vëllezërit nga Sh..., nga M..., është pyetur se kush ishin këta persona dhe ku janë tani. Dëshmitari A është përgjigjur “*se pasi që të njëjtit janë larguar nga burgu ata kanë qenë larg nga ai por fati i tij nuk i ka takuar kurrë dhe kështu nuk e din se ku janë ata njerëz tani, ai ka shtuar se nuk është përpjekur asnjëherë që të bie në kontakt me ta apo t’i takoj ata*”. Po ashtu i njëjti është pyetur se a mund të na jepni detaje më shumë rreth tyre, sepse janë të interesuar që t’i thërrasin si dëshmitar, ai ka shtuar se ai nuk është përpjekur asnjëherë të bie në kontakt me ta për t’i mbledhur në një grup për të shkuar kundër J.D. Lidhur me vëllezërit nga Sh... është pyetur rreth asaj se a ishte i pranishëm dikush kur janë kapur këta vëllezër, dhe se e ka qenë ndokush i pranishëm gjatë rrahjes, i njëjti është përgjigjur “*po ka pasur disa njerëz të pranishëm, ka qenë G.V dhe në qoftë se nuk gabohen ka pasur njerëz të tjerë ku ne ishim 4 total në atë dhomë, lidhur me emrat ka deklaruar se ishin F.M, H. dhe G., e po ashtu në momentin kur është rrahur ky person ai ka shtuar se ka qenë të pranishëm tre vëllezërit, vetja e tij dhe ata që sapo i ka përmendur*”. Mbrojtësi i të akuzuarit J.D, Avokati Mexhid Sylja e ka ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë në prokurori ku ka deklaruar se askush nuk ka qenë i pranishëm kur ai është rrah me përjashtim të tij, i njëjti ishte përgjigjur “*unë nuk them se ju jeni gabim, unë nuk them atë*”.

Dëshmitari A në seancën e datës 18.07.2014 në pyetjet e Avokati mbrojtës të të akuzuarit S.S, avokat Gregor Guy Smith ishte deklaruar si në vijim: lidhur me incidentin e ndodhur me vëllezërit nga Sh... ka deklaruar se, në qeli kanë qenë 3 vëllezër nga Sh..., ku kanë qenë përpos atij edhe G... edhe persona tjerë të pranishëm, ku i njëjti ka shtuar se në këtë pikë nuk e mban mend mirë, por ka qenë G.V, ska qenë i sigurt për H.M, ndërsa i pranishëm ka qenë edhe F.M.

I njëjti përgjatë deklaramit të tij lidhur me këtë përgjigje i është lexuar nga ana e Avokatit Gregor Guy Smith deklarata e dhënë në seancën e datës 25.06.2014 ku i njëjti në pyetjen Prokurorit të EX-it: “*nëse flasim për rrahjen e vëllezërve, a kanë qenë të pranishëm G.V, H.M dhe F. M?*”, po e përsëris edhe një herë, “*nëse flasim për rrahjen e vëllezërve, gjatë asaj kohe, a kanë qenë edhe F.M, G.V dhe H.M*” dhe përgjigja jote është “*G.V dhe unë kemi qenë të pranishëm*”. E di se mund të jetë hutuese por unë po lexoj atë që thuhet në procesverbal. Pasi e dëgjove pyetjen dhe përgjigjen, a e freskon kjo kujtesën tënde lidhur me atë se kush ka qenë i pranishëm gjatë kësaj rrahje”, ai ishte përgjigjur se “*mendoj se vetëm G.V ka qenë i pranishëm sepse të tjerët janë sjellë më vonë*”, dhe se lidhur me arsyen se pse ata janë sjellë aty ka qenë se ata i kanë shitur qingja serbëve e jo shqiptarëve.

Dëshmitari A është pyetur edhe lidhur me kohëzgjatjen e qëndrimit të këtyre vëllezërve në qeli, ku ka shtuar se ata me siguri kanë qëndruar aty për një natë se nuk është i sigurt vetëm një natë apo edhe të dytë, ai ishte i sigurt që kanë qëndruar një natë por sësht i sigurt për natën e dytë. I njëjti është pyetur se vëllezërit nga Sh... a kanë qëndruar me ty në dhomën tënde për 2-3 orë, ai ka shtuar se ata kanë qëndruar së paku një natë në dhomën ku ai është mbajtur. Gjatë deklaramit të tij lidhur me përgjigjen e fundit nga ana e Avokatit Gregor Guy Smith është ballafaquar me deklarimet e tij, ku në pyetjen e Prokurorit të EX-it kur është pyetur, “*a është sjell ndonjë person në qelin e tyre*”, i njëjti është përgjigjur “*për aq sa di, tre vëllezër nga Sh..., ata kanë qëndruar 2-3 orë me mua dhe e shanin UÇK-në*” është pyetur se pse i keni thënë gjykatës që ata kanë qëndruar 2-3 orë, ndërsa dëshmitari është përgjigjur “*jo zotëri, jo 2-3 orë, ata janë sjellë pasdite e kanë kaluar natën aty dhe gjatë natës e shanin UÇK-në*”. Po ashtu përgjatë deklaramit të tij është pyetur nga prokurori se a i keni kontaktuar ndonjë herë këta njerëz që prej atëherë, ai është përgjigjur se nuk ka pasur asnjë kontakt të vetëm me ata, dhe se nuk i ka parë kurrë pas luftës.

Pasi leximit të deklaratave të dëshmitarit A, dhe duke marr parasysh faktin se palët nuk kanë pasur propozime tjera për plotësimin e ndonjë prove – dëgjimin e ndonjë dëshmitari apo leximin e ndonjë deklarate tjetër, ishte proceduar me leximin e provave materiale.

Procedimi i provave materiale

Gjykata kishte vazhduar me rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor ku është vazhduar me leximin-administrimin e provave materiale, deklarimin e të akuzuarve si dhe me fjalën përfundimtare.

Gjykata në këtë seancë ka vazhduar me administrimin e provave materiale, ku si provë të vetme materiale ka administruar:

- Aplikacionin e dëshmitarit “A” për njohjen e statusit të veteranit, pjesëtarit dhe të internuarit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, respektivisht aplikacioni me numër e datës 11.02.2013, pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Po ashtu palët janë pyetur nga ana e kryetarit të trupit gjykues se a kanë propozime tjera për dëgjimin e ndonjë dëshmitari, leximin e deklaratave të ndonjë dëshmitari apo propozime shtesë për plotësimin e provave materiale, ku me këtë rast palët kanë deklaruar se nuk kanë asnjë propozim tjetër. Andaj me këtë rast gjykata ka vazhduar me mbrojtjen e të akuzuarve, respektivisht deklarimin e tyre.

Deklarimi i të akuzuarve

Gjykata kishte proceduar tutje me deklarimin e të akuzuarve, respektivisht për të dëgjuar mbrojtjen e të akuzuarve, por të njëjtit ishin deklaruar si në vijim:

I akuzuari J.D: pas konsultimit me mbrojtësin tim, ne jemi dakorduar që unë të mbrohem në heshtje, arsyeja pse e bëj këtë është për faktin se un nuk e di as për çka akuzohem, andaj edhe nuk e di se për çfarë të flas në këtë çështje, andaj nuk kam arsye pse të mbrohem deri sa e konsideroj vetën tërësisht të pafajshëm. Ndërsa shtoj se deklaratat e mia të dhëna më parë të njëjtat i mbështes.

I akuzuari S.S: pas konsultimeve me mbrojtësin tim kemi vendosur që në aspektin procedural të mbrohem në heshtje dhe arsyeja pse e bëj këtë është që janë gjithë këto vite që unë përballem me këtë proces gjyqësor dhe nuk e di se për çfarë arsye, kënd e kam rrahur, e kënd e kam maltretuar, andaj edhe kjo është arsyeja pse unë nuk kam diçka tjetër që të shtoj. Ndërsa specifikoj se deklaratimet e mia të dhëna më herët për gjatë procedurës i mbështes në tërësi.

Meqë tani të akuzuarit kishin mbështetur deklaratimet e tyre të dhëna në fazat e procedurës penale, të njëjtit kanë dhënë deklaratën e tyre vetëm para prokurorit special e të cilat do të paraqiten në vijim:

I akuzuari S.S më datën 17.07.2013 ishte deklaruar si në vijim: lidhur me objektin e akuzës përgjatë deklaratimit të tij nuk është pyetur specifikisht për ngjarjen që pretendohet që ka ndodhur. Por i njëjti ka potencuar që ka qenë anëtarë i UÇK-së dhe që i është bashkangjitur të njëjtës që përpara vitit 1998, ku në fillim të luftës ka deklaruar që ka pasur vetëm pika më specifikisht është caktuar tek një pikë në A..., ku në atë kohë A.J ka qenë komandat i tyre ndërsa pas vrasjes së tij më datën 5 mars 1998 ata ishin ende duke vepruar në grupe të vogla dhe në periudhën prill/maj të vitit 1998 pas një ri-organizimi është emëruar si komandat i zonës së D.... I njëjti përgjatë deklaratimit të tij është pyetur edhe lidhur me atë se ka pasur bazë të UÇK-së në L..., ku i njëjti ka deklaruar se ka pasur, por është themeluar më vonë, pasi janë formuar Brigadat dhe janë propozuar dhe përzgjedhur komandantët e Brigadave, e që në fillim janë formuar Brigadat 112, 113 dhe 114 e që Brigada 111 është formuar më vonë, i njëjti ka theksuar se ky ka qenë komandat i të gjitha Brigadave. Ndërsa me rastin e riorganizimit, me rastin e ardhjes së shumë ushtarëve i'u është dashur një vend më i madh andaj është themeluar baza e L... për nevojat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Lidhur me atë se a ka pasur ndonjë vend në Shtabin e L... ku janë mbajtur njerëzit duke përfshirë civil i njëjti ka deklaruar që jo.

Po ashtu i njëjti është pyetur lidhur me atë se a e njef J.D, ai ka deklaruar që po, dhe në pyetjen se përgjatë vitit 1998 e ka parë ndonjëherë të njëjtin në L... ai ka deklaruar se jo pasi që ata kanë qenë të vendosur në shtëpinë e tyre në A... që është rreth 2 km nga L... e që pozita e J. ka qenë si Komandant i Brigadës 111 në Shtator. Sa i përket akuzave të cilat i vihen në barrë ai ka theksuar se të gjitha akuzat ndaj tij janë të sajura dhe se ka deklaruar se i njëjti gjithnjë është përpjekur të punoj me nder dhe se ka dhënë gjithçka për atdheun e tij.

I akuzuari J.D më datën 24.05.2013 ishte deklaruar si në vijim: lidhur me objektin e akuzës përgjatë deklaratimit të tij nuk është pyetur specifikisht për ngjarjen që pretendohet që ka ndodhur. I njëjti ka deklaruar se ka qenë pjesëtar i UÇK-së dhe është bërë pjesë e saj nga fundi i vitit 1995. Në fillimet e para të luftës në muajin Mars 1998 ka deklaruar se ishin grupe të vogla, e ku deri në fund të Korrikut 1998 ka filluar funksionimi si një njësi e quajtur "G...A.", ndërsa në fund të muajit Korrik ka theksuar se ka filluar konfigurimi i Njërive dhe janë krijuar Brigada, e i cili në muajin Gusht është caktuar si Komandant i Brigadës 111 "A.J", me bazë në A... të E..., i cili deri në fund të luftës ka qenë Komandat i Brigadës 111 dhe se ka qenë gjatë periudhës së muajve Gusht-Shtator 1998 në L.... Lidhur me atë se a e ka pasur UÇK-ja bazën në L... i njëjti ka deklaruar se kanë qenë dy zyre ku shtabi i përgjithshëm për regjionin e D... ku ndodhej dhe S.S ishte komandat i zonës. Sa i përket takimeve me S.S ka theksuar se e ka takuar një herë në fshatin

P..., kur u vendos që S.S të bëhej komandat dhe pas kësaj here nuk i kujtohet nëse e ka takuar më në L.... Po ashtu i njëjti është pyetur edhe lidhur me atë se përveç komandës së zonës a ka pasur burg apo qendër të mbajtjes në L..., ai ka theksuar se nuk ka parë ndonjë burg apo qendër të mbajtjes.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurorja Speciale në fjalën e saj përfundimtare ishte deklaruar si vijon: se pas administrimit të të gjitha provave në shqyrtimet kryesore në mënyrë të qartë u vërtetua se të akuzuarit J.D dhe S.S kanë kryer veprën penale për të cilat ngarkohen sipas aktakuzës PPS.nr.88/2011. Dhe atë “*Krime Luftë kundër popullatës civile*” në kundërshtim me nenin 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Gazeta Zyrtare RSFJ nr 44 të datës 8 tetor 1976 aktualisht e Penalizuar sipas neneve 31 dhe 152 të Kodit Penal të Kosovës dhe në nenet e përbashkëta 3 dhe 4 të Protokollit Shtesë II të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar që ishin në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm në Kosovë. Ka shtuar se nga provat e prezantuara në shqyrtimet kryesore dhe atë të leximit të deklaratës së dëshmitarit A që u lexua me propozimin e avokatëve dhe me pëlqimin e të gjitha palëve u vërtetua se të dy të akuzuarit J.D dhe S.S gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe atë ndërmjet fillimit të gushtit deri në fund të shtatorit 1998 duke vepruar si anëtarë të UÇK –së dhe në bashkryerje me njëri tjetrin ashtu siç është përcaktuar në nenin 31 të KPK –se qëllimisht kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një personi tjetër të paidentifikuar shqiptar nga zona e Sh... në M... të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në L... duke e rrahur atë vazhdimisht.

Lidhur me deklarinimin e dëshmitarit A e njëjta ka theksuar se dëshmitari ka sqaruar se më datë 15 Gusht 1998 dy ushtarë të UÇK-së kanë ardhur me një automjet terreni në shtëpinë e tij ku e kanë parkuar automjetin afër derës dhe kanë hyrë në oborr se i njëjti ka qenë në oborr dhe këta dy persona kanë qenë të veshur me uniforma të kamufluara të UÇK-së dhe se kanë pasur pushkë dhe revole. I njëjti ka dëshmuar se këta dy persona ishin prezantuar si polic ushtarak dhe kishin urdhëruar këtë dëshmitar të shkonte me ata duke i thënë se kishin urdhër nga S.S për ta dërguar atë në L... dhe se i njëjti duhet të jepte deklaratën e tij dhe se i njëjti është bindur urdhrave të tyre, dhe posa kanë arritur në L... ky dëshmitar se bashku me dëshmitarin B u futën në dhoma të ndara në ndërtesën e ish stacionit të policisë ku në atë kohë UÇK-ja kishte shtabin atje dhe se kjo ndërtesë ka qenë e dëmtuar nga bombat dhe nuk ka pasur kulm por pllaka betoni dhe dhoma ku me kanë vendosur ka pasur një dritare të vogël me grilla dhe një dry dhe është dukur si qeli paraburgimi, dhe ka qenë një shtrat me zingjir i cili ishte i lidhur me këmbët e drurit, kurse dera ka qenë e drurit dhe ka qenë e mbyllur me qelës nga jashtë.

Gjithashtu ky dëshmitar përshkruan rastin në mënyrë të njëjtë se si i ka njohur shumë mirë dy të akuzuarit S.S dhe J.D dhe gjatë kohës sa ka qëndruar në këtë ndalim e ka takuar disa herë S.S por përveç tij ka pasur edhe persona tjerë të ndaluar ku ky dëshmitar i ka parë nga kati i dytë, kur dy të akuzuarit kanë rrahur edhe një person tjetër nga Sh... M.... Se dëshmitari A ka aplikuar për statusin e veteranit të UÇK –së përputhet me deklaratën e tij ku ky dëshmitar pasi i njëjti ka deklaruar se ka qenë mbështetës i UÇK –së me strehim dhe ushqim dhe se i njëjti nuk ka qenë kundër UÇK –së siç e kanë etiketuar dy të akuzuarit.

Andaj sipas gjithë kësaj në rastin konkret dy të akuzuarit kanë shkelur integritetin trupor të burgosurit dhe se ky është një rast individual i shkeljes se integritetit trupor të ndaluar në L....

Andaj versioni i dëshmitarit A i ngjarjeve është konstatuar i besueshëm për prokurorin nuk përmban ndonjë element që do të kundërshtoj nga njohuritë e përgjithshme apo mendja e shëndosh, për më tepër ishin përbrenda të qëndrueshme dhe të besueshme nuk ka pasur mos përputhje në kallëzimin e tij edhe pse dëshmitari është pyetur vazhdimisht për çështjen e njëjtë avokatët e të akuzuarve kanë paraqitur disa sfida për besueshmërinë e dëshmitarit A sidomos në lidhje me datën kur ka ndodhur ngjarja, por për rastin se si është rrahur dëshmitari A nga S.S

tani ekzistojnë edhe Aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë si dhe Aktgjykimet e Gjykatës Supreme. Andaj Prokuroria duke analizuar me kujdes dëshminë e këtij dëshmitari e cili ishte provë e vetme për vërtetimin e fakteve që kanë ndodhur në L... ka ardhur në përfundim se dëshmia e dëshmitarit A është e besueshme dhe si dëshmi e tij jep një pamje të qartë se të pandehurit në bashkëkryerje me njëri tjetrin qëllimisht i kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një mashkulli të paidentifikuar shqiptar duke e rrahur në mënyrë të përsëritur në L... dhe se rrëfimi i tij përputhet me kushtet e larta të besueshmërisë dhe i plotëson kërkesat bazë e vetme për verdikt fajësues. Prokuroria pranon se identiteti i viktimës është i panjohur dhe sipas praktikës së Tribunalëve Ndërkombëtare karakteristikat e krimeve të luftës bartin mundësinë që viktimat e krimeve të mbeten të panjohura por është e mundur të vërtetohet se veprimet kriminale kundër civileve të panjohur ka ndodhur është kryer.

Sistemi i drejtësisë penale synon të sjell drejtësi për viktimat pa marrë parasysh a janë të identifikuar apo jo për me tepër duke ju referuar dëshmisë së dëshmitarit A, ku ky dëshmitar në mënyrë të përsëritur e përshkruan rrahjen e një mashkulli nga Sh... gjë që është e pa plot por është referencë e vetme për identitetin e tij dhe se rrethanat e rrahjes se tij po ashtu mbeten konsekuente dhe të pandryshuara gjatë gjithë rrjedhës së procedurës.

Prokuroria mbron qëndrimin se karakteristikat e këtij veprimi kriminal nuk mbështeten thjesht në pragun e dëmtimit trupor të viktimës por në kornizën e tërësishme të fatit të tij dhe se pesha e shkeljes së të drejtës humanitare ndërkombëtare mund të vlerësohet në lidhje me të gjitha kushtet e viktimës e dhuna fizike është vetëm njëra prej tyre, dhe nga kjo është vërtetuar se viktima është mbajtur dëmtuar dhe keqtrajtuar nga kryesi në qendrën e ndalimit në L... pa pëlqimin e tij duke u rrahur dhe mbajtur në kushte të këqija dhe se i njëjti është rrahur para të ndaluarve të tjerë të paktën para dëshmitarit A dhe vëllezërve të tij në mënyrë poshtëruese dhe nënçmuese për të shërbyer shembull frikësimi ndaj të ndaluarve të tjerë.

Arsyeja e rrahjes ishte mungesa e respektit nga ana e tij për pjesëtarët e UÇK-së, asnjë nga të ndaluarit që ishin dëshmitarë të rrahjes nuk i'u është lejuar që t'i ndihmojnë atij në fatin e tij dhe të gjitha këto e rrisin në mënyrë të konsiderueshme peshën e këtij akti të kryer, ashtu që dëshmitari A i ka identifikuar kryerësit dhe atë J.D dhe S.S.

Sipas nenit 3 të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 sa i përket prezumimit të statusit civil të viktimave thotë që personat që nuk marrin pjesë aktive në armiqësitë, përfshirë pjesëtarë të forcave të armatosura të cilët kanë lëshuar armët e tyre dhe ata të cilët janë të paafte në luftë për shkak të sëmundjeve dhe plagëve e që në rastin konkret nga dëshmitari A u vërtetua se mashkulli nga Sh... nuk ka qenë pjesëtar dhe nuk ka marrë pjesë aktive në armiqësi i cili ishte ndaluar në L... por që ishte rrahur nga dy të akuzuarit u vërtetua në të gjitha seancat e shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura në Qershor të vitit 2014.

Sa i përket të drejtës materiale në fuqi ka theksuar se Prokuroria i ka kushtuar vëmendje kësaj çështje dhe që në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në fuqi që nga Janari i vitit 2013 krahas Kodit Penal të RSFJ-së andaj prokuroria ka vlerësuar vetëm të drejtën materiale në fuqi.

Neni 3 i KPRK-së, Kodi në fuqi në kohën e procedurës parasheh:

- Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale
- Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është me i favorshëm

Në vitin 1998 kur është kryer vepra me të cilën ngarkohen të akuzuarit në fuqi ka qenë Kodi Penal i RSFJ-se i vitit 1977 i ndryshuar me kushtetutën e RFJS-së i vitit 1992 i cili ka shfuqizuar zbatimin e dënimit me vdekje.

Ndërkohë Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës ka qenë në fuqi nga data 6 prill 2004 deri në vitin 2013.

Në nenin 142 të RSFJ-se thuhet:

“Kushdo që me shkelje të drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit urdhëron që popullata civile t’i nënshtrohet vrasjeve, torturës, trajtimit çnjerëzor, eksperimenteve biologjike, vuajtjes së pafund ose cenimit të integritetit trupor ose shëndetit dhe kushdo që kryen njërin nga aktet e mëposhtme dënohet me burgim jo me pak se 5 vjet.

Neni 38 i RSFJ-së thuhet:

- Dënimi me burgim nuk mund të jetë me i shkurt se 15 ditë ose me i gjatë se 15 vite
- Gjykata mund të shqiptoj dënimi me burgim prej 20 vitesh për veprën penale që i plotëson kërkesat për dënim me vdekje

Neni 120 paragrafi 1, të KPPK-së:

“Kushdo që shkel rendë nenin 3 që është i përbashkët me 4 Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dënohet me se paku me 5 vjet burgim ose me burgim afatgjatë”

Po ashtu Konventa e Gjenevës lidhur me veprat e kryera në vitin 1998 është në përputhje me nenin 33 dhe 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përmban zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare mes tjerash edhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ) dhe Konventa Ndërkombëtare për të drejtat Civile Politike dhe Protokollet e saj (KNDCP).

Të dy këto instrumente domethënien e nenit 7 paragrafi 2 të KEDNJ-se dhe nenit 15 par. 2 KNDCP-së përmbajnë dispozitivin në vijim:

“Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim i cili në momentin kur është kryer quhet veprë penale sipas parimeve të përgjithshme të drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara”.

Andaj mbi bazën e të gjitha këtyre se ka ekzistuar një burg në L... është fakt i pakontestuar pasi që i kanë edhe Aktgjykimet e formës së prerë se S.S ka qenë komandat i zonës operative të D..., i cili gjithashtu është fakt i pakontestuar, andaj mbi bazën e të gjitha të akuzuarit J.D dhe S.S janë fajtor për veprën penale “Krime Luftë kundër popullatës civile” në kundërshtim me nenin 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Gazeta Zyrtare RSFJ nr 44 të datës 8 tetor 1976 aktualisht i Penalizuar sipas neneve 31 dhe 152 të Kodit Penal të Kosovës dhe në nenet e përbashkëta 3 dhe 4 të Protokollit Shtesë II të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar që ishin në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm në Kosovë.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.D, Avokat Mexhdi Syla në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon:

se kjo fjalë përfundimtare paraqet kundërshtimin e mbrojtjes së J.D vetëm për pikën 3 të akuzës të Prokurorisë Speciale. Ku sipas kësaj pike të aktakuzës J.D akuzohet se në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së në bashkëkryerje me S.S ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një personi të pidentifikuar nga lagjja Sh... në M..., i ndaluar në qendrën e ndalimit duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritshme. Tutje ka shtuar se nga përmbajtja-formulimi i paraqitur në dispozitiv të aktakuzës rezulton se aktakuza është krejtësisht e paqartë dhe konfuze, ku me dispozitën e nenit 235 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5 dhe 1.7 është përcaktuar se aktakuza duhet të përcaktojë saktësisht kohën, vendin, mjetin dhe objektin me të cilin është kryer vepra penale si dhe rrethanat tjera të nevojshme për tu përcaktuar me saktësi kryerja e veprës penale, që në rastin konkret është e pashmangshme të vërtetohet natyra e lëndimeve eventuale për personin e dëmtuar, ndërsa me pikën 1.7 të kësaj dispozite është përcaktuar se aktakuza duhet të përmbajë shpjegim të arsyeshëm duke u bazuar në rezultatin e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore se është kryer vepra penale, e që në këtë rast penal nuk janë plotësuar këto kushte, ngase asnjëherë nuk është identifikuar viktimat, nuk dihet kohë kur kinse ka ndodh ngjarja, nuk

janë vërtetuar lëndimet eventuale që i ka pësuar, natyra e tyre, mjete me të cilin janë shkaktuar dhe rrethanat tjera me rëndësi për të ekzistuar vepra penale e pretenduar.

Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka shtuar se prezumimi i pafajësisë, çdo personi të akuzuar i siguron të drejtën të konsiderohet i pafajshëm deri sa me prova nuk dëshmohet se akuza kundër tij përtej dyshimit të arsyeshëm. Kjo normë është përcaktuar me nenin 6 par.2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 31 pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 3 të Kodit të Procedurës Penale ku thuhet “*çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm deri të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë së Gjykatës. Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës*”, e që nga përmbajtja e shkresave dhe fjalës përfundimtare të prokurorit, rezulton se prokurori aktakuzën e mbështet krejtësisht në dëshminë e dëshmitarit A të dhënë në prokurori më 13.12.2011, dhe në seancat e shqyrtimit gjyqësorë të mbajtura më 25.06.2014, 17.07.2014 dhe 18.07.2014.

Prokuroria në këtë rast nuk ka siguruar asnjë provë tjetër që e mbështet dëshminë e dëshmitarit A sa i përket kësaj pike të aktakuzës, e që nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të vërtetuar identitetin e personave për të cilët në aktakuzë thuhet se kinse kanë qenë të ndaluar dhe njëri prej tyre është keqtrajtuar duke u rrahur, e që edhe sot në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i akuzës shumë shkurt dhe në mënyrë të përgjithësuar i referohet kësaj pike të aktakuzës pa dhënë sqarime se cila rrethanë vërtetohet me dëshminë e këtij dëshmitari dhe pa e përmendur asnjë provë tjetër që e mbështet atë që ka deklaruar, e që duke analizuar fjalën përfundimtare të përfaqësueses të akuzës të paraqitur shihet se bëhet fjalë për deklaratat e këtij dëshmitari të dhëna lidhur me të ashtuquajturin Rasti D... në përgjithësi, përkundër faktit se ashtu si janë dakorduar në seancën e shqyrtimit kryesor 12.04.2024, ku objekt shqyrtimit tani në këtë fazë është vetëm pika e III e aktakuzës dhe si provë do të administrohen vetëm deklaratat e dëshmitarit A të dhëna në prokurori dhe në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura më parë sa i përket kësaj aktakuze. Në këtë rast përfaqësuesi i akuzës nuk i referohet asnjë prove që mbështet dëshminë e këtij dëshmitari, qoftë ajo provë gojore apo materiale. Sa i përket dëshmisë së këtij dëshmitari A, kjo provë nuk ka vlerë provuese, meqë dëshmitari A në dëshmitë e tij është kundërthënëse në rrethanat kryesore, ka manifestuar pasiguri gjatë dëshmisë së tij dhe dëshmia e tij nuk është mbështet me asnjë provë tjetër të administruar. Këto kundërthënie janë të shumta të cilat janë manifestuar në të gjitha rrethanat për të cilat ka pretenduar se ka ndodhur lidhur me personin enigmatik nga Sh... i M..., dëshmia e tij është kundërthënëse dhe e pasigurt lidhur me atë kur e kanë sjellë ata persona aty, kohën sa ka qëndruar, kush ka qenë prezent përveç dëshmitarit A, kur ata kanë qenë në dhomën e tij, dhe arsyet pse janë sjell aty. Duke pasur parasysh se sa kundërthënës janë deklaratimet e tij përgjatë deklarimeve qoftë në seancat gjyqësore qoftë në prokurori, kredibilitetit i dëshmitarit është i paqëndrueshëm si dhe pretendimi i përfaqësuesit të akuzës kur dëshmitarin A e vlerëson si kredibil dhe të besueshëm, e që mbrojtja vlerëson se këto qëndrime të paraqitura janë krejtësisht të pabazuara dhe në kundërshtim me provat e administruara, sepse ka shumë prova që vërtetojnë pa mëdyshje faktet dhe rrethanat se kemi të bëjmë me dëshmitarë jokredibil e sa për ilustrim ka përmendur edhe disa raste: nuk mund të thuhet se është kredibil një dëshmitar nëse e kaluara e tij tregon se është njeri problematik-konfliktuoz që ka ardhë në kundërshtim me ligjin ashtu si është rasti me dëshmitarin A, gjykatës i është njohur fakti për rrahjet dhe tentim vrasjet e këtij dëshmitari me fqinjët e tij vëllezërit D..., të akuzuar për rastin tjetër e po ashtu është i paqëndrueshëm pretendimi i prokurorit se përgjigjet që dëshmitari ka dhënë kanë qenë të singerta dhe të sakta dhe se nuk kanë zbuluar asnjë paragjykim apo motiv personal kundër të akuzuarve. Ku mbrojtja ka vlerësuar se në dëshminë e dëshmitarit A pa mëdyshje është manifestuar një tendencë që me çdo kusht ta rëndojë pozitën juridike të J.D duke deklaruar për rrethana që nuk janë provuar me asnjë provë. Kredibiliteti i këtij dëshmitari është vënë në pyetje

edhe me vetë veprimet e tij, i cili gjatë dëshmisë ka deklaruar se asnjëherë nuk ka qenë pjesëtar i UÇK-së, dhe përkundër kësaj dëshmitari ka aplikuar për njohjen e statusit të veteranit duke paraqitur të dhëna të rrejshme në aplikacionin për njohje të statusit të veteranit. Andaj dhe krejt në fund duke patur parasysh atë që u tha më lartë, ri përsërisë konkludimin se Prokuroria nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor që Gjykatës t'i ofrojë prova për t'u vërtetuar dyshimin e mirë bazuar se J.D ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar andaj ka kërkuar nga Gjykata që të njëjtin konform nenit 364 par 1 pika 3 të KPPK-së ta lirojë nga akuza.

I akuzuari J.D në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: unë do të ritheksoj ato që kishte thënë njeriu më përgjegjës brenda gjykatës së EX-it në Kosovë se procesi ndaj nesh ishte i padrejtë, i pa bazuar në fakte, i politizuar e me tendencë të përmbushjes së normës nga një trup gjykues i EX-it, për të dënuar në emër të krimeve të luftës, duke inekuuar rastin, për të siguruar pozita e favore brenda misionit të BE-së. Këto janë konstatimet e ish Kryetarit të Gjykatësve të EX-it M.S në imelat e tij zyrtare në komunikime me udhëheqësit e misionit BE-së në Kosovë dhe në B... Tutje i njëjti ka shtuar se sa i përket Dëshmitarit A për shpifjen e tij nuk ka se çka të flet. Ndërsa sa i përket rastit të D..., në rastin D... II 10 veta jemi dënuar nga një trup gjykues i EX-it i formuar në mënyrë të parregullt, duke u bazuar vetëm në dëshminë – shpifje të këtij dëshmitari, me akuzën se gjoja ne e kemi rrahur gjatë luftës në një periudhë të pacaktuar në L... dhe se në emër të kësaj nuk është bërë drejtësi por padrejtësi. Tutje ka shtuar se sa i përket dëshmitarit A se përse ka gënjyer ky njeri dhe për çfarë qëllimi e ka bërë është i bindur se arsyt ndërlidhen me atë se: i njëjti për shkak të problemeve të rënda shëndetësore mentalisht gjë që e ka dëshmu edhe raporti mjekësor që ishte trajtuar në neuro-psikiatri gjatë vitit 2003, raport të cilin e ka dorëzuar vet vëllai i tij gjatë një seance në rastin D... I, dhe se dëshmitari A kushtet ekonomike i ka pas të dobëta dhe premtimet e bëra nga hetuesit e EX-it për një jetë më të mirë, vetëm që të dëshmojë sipas dëshirës së tyre, ka qenë një mundësi shumë e favorshme për ta përdorë atë të shpikë gjëra që fare nuk kanë ekzistuar. E për ta inskenuar rastin si krim lufte, për t'i dhënë publicitet e për të bërë të dukej si rast i rëndësishëm dhe i nivelit të lartë, mundësia më e mirë ka qenë të na përfshijnë neve, pasi që ishim në pozita të rëndësishme publike në atë kohë e gjatë luftës ishim edhe pjesëtarë të UÇK-së duke i shërbyer me nder luftës për liri të vendit të tyre. E ajo që vlen të theksohet është se Dëshmitari A na ka njohur pasi që ka jetuar aty në fshat, e kjo ka qenë mundësi shumë e favorshme për hetuesit e EX-it, që më lehtë të improvizojnë gjithçka e që fatkeqësisht edhe rrjedha e atij procesi ka treguar se edhe ai panel i gjyqtarëve të EX-it kanë shërbyer atij misoni e jo drejtësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.S, Avokati Artan Qerkini në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: se edhe pas rikthimit në rivendojse të kësaj pike të aktakuzës u provua se S.S nuk ka kryer veprën penale nga pika 6 e aktit akuzues. Siç është potencuar edhe në fjalën hyrëse e vetmja deklaratë që e inkriminon S.S dhe J.D në kryerjen e pretenduar të kësaj vepre penale është dëshmia e Dëshmitarit A, pra e një dëshmitari i cili është në tërësi jo kredibil dhe i cilin në lidhje me të gjithë pikat e akuzës, e sidomos në lidhje me pikën 6 në raport me S.S përveç se ka dhënë dëshmi të rrejshme, dëshmia e këtij dëshmitari është në kundërshtim me deklaratat e tij të dhëna në këtë procedurë penale. I njëjti ka shtuar se në faqen 23 të aktakuzës pika 9 me titullin “rrahja e një të burgosuri nga Sh... i M..., Prokuroria duke cituar deklaratën e Dëshmitarit A të dhënë në fazën e hetimeve thekson se Dëshmitari A tutje dëshmon që në një pikë gjatë qëndrimit të tij në burg, tre vëllezër nga Sh... i M... janë sjellë në dhomën e tij, sepse pretendohet se ju kanë shitur dele serbëve, ndërsa në seancën gjyqësorë të datës 25 Qershor 2014 në pyetje të prokurorit rreth incidentit të pretenduar në pikën 6 të aktakuzës përgjigjet si në vijim “*unë thash se tre vëllezër nga Sh... i M... janë sjellë në dhomën time dhe po e përsëris se vetëm njëri prej tyre është rrahur në prezencën time, sepse ai ka sharë UÇK-në dhe është bërë sikurse është i çmendur*”. Pra kundërthënia e arsyeve se pse kinse vëllezërit nga Sh... janë mbajtur dhe njëri është rrahur mese evidente, ndërsa kur është pyetur dëshmitari A në fazën e hetimeve se pse janë

mbajtur në L... vëllezërit nga Sh... ka thënë se “ju kanë shitur dele serbëve”, ndërsa kur është pyetur në shqyrtim gjyqësorë në lidhje me të njëjtën rrethanë ka deklaruar se arsyeja e mbajtjes dhe rrahjes së njërit prej tyre ka qenë “se e kanë sharë UÇK-në”. Tutje i njëjti ka theksuar se dëshmia e dëshmitarit A nuk mbështetet në asnjë provë qoftë personale apo materiale atëherë pa dyshim se dëshmia e këtij dëshmitari nuk mund të shërbejë si provë për një aktgjykim dënues. Vetë mënyra se si është konstruktuar kjo pikë e aktakuzës e cenon të drejtën e të akuzuarit për mbrojtje efektive, ku kjo pikë e aktit akuzues përmend tre persona të cilëve nuk u dihet identiteti, njëri prej të cilëve pretendohet se është rrahur, e nëse mbrojtja dhe të pandehurit do të ishin në dijeni të identitetit të tyre do të kishte mundësi t’i thërras këta persona me qëllim që t’i ballafaqoj me deklaratat e dëshmitarit A. Sa i përket këtij dëshmitari ka shtuar se testin të cilin do të duhet të kalojë një deklaratë e dëshmitarit në mënyrë që të jetë e besueshme përfshinë por nuk kufizohet në: realitetin objektiv, e që ka të bëjë me përputhshmërinë e deklaratës së dëshmitarit me ngjarjet e asaj kohe për të cilën jep dëshmi, mungesën e kundërthënies në dëshmi dhe mbështetjen e deklaratës së dëshmitarit në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë apo në prova materiale. Ku asnjërin prej këtyre kriterëve dëshmia e Dëshmitarit A nuk e plotëson, prandaj e njëjta nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet provë e besueshme mbi të cilën Gjykata mund të mbështes vendimin e saj.

Ka shtuar se mbesin pranë fjalës hyrëse të cilën e kanë paraqitur në këtë shqyrtim gjyqësorë dhe se nisur nga ajo që është thënë deri më tani, mbrojtja deri më tani arrin në këto përfundime: dëshmia e dëshmitarit A është në tërësi e pabesueshme në vetë përmbajtjen e saj, dëshmia e dëshmitarit A nuk mbështetet nga asnjë provë personale edhe provë materiale, dëshmia e dëshmitarit A është kundërthënëse me vet vetë si dhe faktet materiale të prezantuara në pikën 6 të aktit akuzues nuk përbëjnë shkelje të nenit 4 paragrafi 2 (a) të Protokollit 2 të Konventave të Gjenevës, prandaj si epilog i vetëm ligjor dhe i drejtë i kësaj çështje penale është aktgjykimi lirues për të dy të akuzuarit.

I akuzuari S.S në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit tim, shtoj se kur prokurori specifikoje dhe propozoj që ne të shpallemi fajtor dhe të dënohemi sipas ligjit, andaj këtë çështje e konsideroj aç sa tragjike po aç edhe komike, tragjike është për faktin se tani po bëhen rreth 25 vite që kemi mbajtur dënime ashtu siç e specifikoje edhe parafolësi im J., është e rëndë me mbajte burgim për një vepër penale të cilën ne nuk e kemi kryer dhe ne kemi mbajtur burg pa e ditur fare se pse e kemi mbajtur këtë burg, në bazë të një deklaratë të një dëshmitari i cili ka shpikur. Ndërsa sot prap jemi këtu për të njëjtën çështje me deklaratë të njëjtit dëshmitar që specifikon se unë e kam rrahur dikënd, ndërsa unë nuk e kam të kjtartë se kënd e kam rrahur. Meqenëse avokatët i thanë të gjitha fjalët un dola këtu vetëm tua argumentoj edhe një herë për kohën për të cilën po flasim në kohën kur un kam qenë komandant i zonës operative të D... ku këtë detyrë e kem marr pas rënies së komandantit legjendar A.J, dhe po flasim për kohën kur Sh... thotë se ne shtab të L...it un kam pi kafe dhe gjitha forcat i ka përqendruar në D... dhe për këtë periudhë kohore un kam pasur shumë bashkëlufetar të vramë civil të vrave e të plagosur, ku objekti i cili ka qenë i djegur kur kanë mbrri forcat Serbe, dhe prap unë akuzohem se e kam rrahur një njeri në këtë objekt, ku në këtë objekt janë mbajtur takimet të niveleve të larta diplomatike, ku për këto çështje ne kemi edhe dëshmi të cilat janë të dokumentuara. Atëherë si është e mundur që ne ofensivat me të mëdhaja ku ne kemi pasur njerëz të vrarë dhe të plagosur, si është e mundur që unë paskam mundur të shkoj në 12 të natës dhe të rrah një person, pasi që ky objekt ka qenë i djegur dhe unë jam dashur të udhëtoj së paku 5- deri 10 km për të shkuar për ta rrahur këtë person. Andaj për mua personalisht është fyese të thuhet se unë kam rrahur një person, sepse i njëjti nuk i ka shitur dele UÇK-së. Siç kam specifikuar edhe më herët për mua është frustuse dhe zhgënjyese që unë akuzohem vetëm mbi këtë deklaratë, sepse sot unë nuk di as çfarë t’ju them fëmijëve të mi se

për çka unë akuzohem. Krejt në fund dua të specifikoj se un kam luftuar ndershëm për çlirimin e vendit tim dhe kjo është krenaria e jetës time.

VLERËSIMI I PROVAVE

Gjykata në vazhdim do të analizoj secilën provë të cilat janë trajtuar e elaboruar për gjatë shqyrtimit gjyqësor, respektivisht provat si vijon:

Provat personale dhe materiale.

1. Dëshmitë e dëshmitarit A, të dhëna në Prokurori më datën 13.11.2011, si dhe Deklaratat e dhëna në seancat e shqyrtimit gjyqësorë të mbajtura më datat 25.06.2014, 17.07.2014, 18.07.2014.

2. Aplikacioni i dëshmitarit "A" për njohjen e statusit të veteranit, pjesëtarit dhe të internuarit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, respektivisht aplikacioni me numër e datës 11.02.2013, pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Gjykata në vazhdim do të trajtoj secilën provë veç e veç dhe do nxjerr përfundimet për çështjet dhe faktet që i ka vërtetuar-si ka vërtetuar për gjatë shqyrtimit gjyqësorë.

Për këtë gjykatë, nuk ka qenë kontestuese fakti se të akuzuarit J.D dhe S.S kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (tutje UÇK-së), pasi që të njëjtit në asnjërin prej deklarimeve të tyre nuk e kanë mohuar këtë fakt. E po ashtu për gjykatën nuk ka qenë kontestuese se në L... ka ekzistuar baza e UÇK-së, pasi që një rrethanë të tillë e kanë konfirmuar të dy të akuzuarit përgjatë deklarimeve të tyre. Fillimisht i akuzuari S.S ka theksuar se UÇK-ja ka pasur bazë në L... pasi që janë formuar Brigadat dhe se kjo bazë është themeluar për nevojat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ndërsa i akuzuari J.D po ashtu sa i përket bazës së L... ka theksuar se kanë qenë dy zyre që kanë shërbyer për shtabin e përgjithshëm për regjionin e D....

Kontestuese për gjykatën ka mbetur të vërtetohet thelbi i pretendimit të aktakuzës e që është fakti po që se të akuzuarit J.D dhe S.S: *"në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari J.D në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në bashkëkryerje me S.S po ashtu në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një personi të pidentifikuar nga lagja Sh... në M..., i ndaluar në qendrën e ndalimit të L..., duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritshme"*, pra kontestuese ka mbetur të vërtetohet fakti, nëse të akuzuarit J.D dhe S.S në bazën e UÇK-së në L..., a kanë cenuar integritetin trupor të personit të pidentifikuar ashtu siç pretendohet nga Prokuroria, e ku prokuroria pretendimin e lartcekur e mbështet në deklaratën e një dëshmitari të vetëm e që është dëshmitari A.

Kjo gjykatë për gjatë analizimit të deklarimeve të Dëshmitari A, për çështjet kryesore që përbëjnë edhe përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës, duhet theksuar faktin se i njëjti, fillimisht në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori të datës 13.12.2011 kishte theksuar se më kujtohen tre vëllezër nga Sh..., zona e M... të cilët ishin sjellë në dhomën time, sepse gjoja ata kishin shitur disa dele serbëve dhe se të njëjtit janë mbajtur aty për dy net radhazi, tutje lidhur me rrahjen e këtyre vëllezërve ka shtuar se të akuzuarit S.S dhe J.D kanë rrahur njërin prej tyre në dhomën e tij gjatë ditës, pastaj të rrahurat kanë vazhduar në korridor. Gjatë rrahjes së këtyre vëllezërve ka theksuar se në dhomë kanë qenë të pranishëm H., F. dhe G. dhe se lidhur me emrat e këtyre vëllezërve nuk i din vetëm se i kujtohet se ata kishin edhe gjashtë vëllezër në familjen e tyre.

Lidhur me deklaratat e të njëjtit në kuadër të shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura më datat 25.06.2014, 17.07.2014, 18.07.2014, fillimisht në seancën e datës 25.06.2014 i njëjti kishte deklaruar se i kujtohet që kanë qenë 3 vëllezër nga mahalla e Sh..., i njëjti ka theksuar se me të kanë qëndruar 2-3 orë në dhomën ku është mbajtur dhe se ata e shanin UÇK-në, sa i përket rrahjes së njërit prej vëllezërve në këtë seancë ka theksuar se e kanë rrahur atë me radhë, njëri këtë herë dhe tjetri herën tjetër, me grushta dhe duke e shqelmuar atë. Në lidhje me këtë rrahje ka shtuar se i pranishëm ka qenë vetëm ai dhe G.V.

Në seancën e datës 17.07.2014 i njëjti ka deklaruar se: gjatë kapjes së këtyre vëllezërve kanë qenë të pranishëm G.V. dhe në qoftë se nuk gabohet se ka pasur edhe njerëz të tjerë po ashtu dhe ishimi total 4 në dhomë, kur është pyetur rreth emrave të këtyre personave ka theksuar se ka qenë i pranishëm F.M, H. dhe G.

Në seancën e datës 18.07.2014 ka deklaruar se në momentin e rrahjes së njërit prej vëllezërve ka potencuar mendoj se vetëm G.V. ka qenë i pranishëm, sepse të tjerët janë sjellë më vonë, dhe se arsyeja se pse janë sjellë ata vëllezër aty ka qenë sa i përket shitjes së qingjave serbëve e jo shqiptarëve, e ndërsa lidhur me qëndrimin e tyre në L... i njëjti ka deklaruar se ata me siguri kanë qëndruar aty për një natë dhe se nuk është i sigurt vetëm një natë apo edhe të dytën.

Përgjatë vështrimit-analizimit të deklaratave të dëshmitarit A për faktet thelbësore-specifike, fakte mbi të cilat është ndërtuar narrativa e përshkrimit faktik të aktakuzës, kjo gjykatë ka arritur të vërej se deklarata e Dëshmitarit A kanë qenë kundërthënëse me vetveten. Në vazhdim kjo gjykatë do të shpjegoj në mënyrë të detajuar se pse deklaratat e dëshmitarit A të dhëna në prokurori dhe përgjatë shqyrtimit gjyqësorë kanë kundërthënënie mes tyre (për faktet thelbësore).

Fillimisht, lidhur me arsyen se pse tre vëllezërit, janë marrë në L..., njëherë dëshmitari ka deklaruar se *“ata e shanin UÇK-në”* e më pastaj ka theksuar se arsyeja se pse të njëjtit i kanë marrë është se *“të njëjtit i kanë shitur qingja serbëve e jo shqiptarëve”*. Tutje, lidhur me qëndrimin e këtyre vëllezërve në dhomën ku kishte qëndruar dëshmitari A ka deklaruar se *“të njëjti janë mbajtur dy net”*, ndërsa përgjatë deklarimeve të tij në seancat gjyqësore ka deklaruar se *“të njëjtit kanë qëndruar 2-3 orë në dhomën ku është mbajtur ai”* dhe se *“ata me siguri kanë qëndruar aty për një natë dhe se nuk është i sigurt vetëm një natë apo edhe të dytën”*. Një tjetër rrethanë që e bën kundërthënëse deklaratimet e tij ka të bëjë me atë se kush ka qenë i pranishëm me dëshmitarin A në dhomë kur janë sjellë këta vëllezër dhe kur është rrahur njëri prej tyre, fillimisht në prokurori ka deklaruar se ka qenë i pranishëm *“vetëm ai dhe G.V.”*, ndërsa përgjatë deklaratimeve të tij në kuadër të seancave gjyqësore ka deklaruar se ishte i pranishëm *“ai, F.M, H. e G.”* e më pastaj ka deklaruar se *“mendoj se vetëm G.V. ka qenë i pranishëm sepse të tjerët janë sjellë më vonë”*.

Nga të thënat më lartë, kjo gjykatë ka konkluduar se i njëjti ka pasur kundërthënënie të vazhdueshme mes deklaratimeve të tij, pasi që i njëjti fillimisht nuk ka qenë i sigurt lidhur me arsyen se pse këta vëllezër janë marrë, se për sa kohë të njëjtit kanë qëndruar dhe se kush ka qenë i pranishëm në momentin kur njëri prej vëllezërve sipas tij është rrahur.

Kjo gjykatë për gjatë analizimit të deklaratës së dëshmitarit A, ka nxjerrë përfundimin se në bindjen e kësaj gjykate, deklaratimet e dëshmitarit A humbasin edhe vetë logjikën e konstatimeve të tij. Fillimisht specifikojmë faktin se përshkrimi faktik i aktakuzës specifikon një fakt për tej dëshmisë së dëshmitarit A, për faktin se konkludojnë se viktimi tani e pa identifikuar është rrahur pa ndërprerë (në mënyrë të përsëritshme), ndërsa dëshmitari A flet për një sekuencë që sipas tij ka zgjatur rreth dhjetë minuta. Se dëshmitari sipas bindjes së gjykatës humbet edhe logjikën në shpjegimin e ngjarjes, rezulton në faktin se ai specifikon se të akuzuarit e kanë rrahur njëri pas

tjetrit personin e pa identifikuar dhe të njëjtin e kanë rrahur deri sa janë lodhur, ndërsa viktima ka qëndruar në këmbë. Si ka mundësi që një person të rrahet pa ndërpre me grushte e me shkelma dhe të vazhdoj të qëndroj në këmbë. Më tej dëshmitari është kontradiktorë për faktin se i njëjti her flet se ata vëllezër kanë qëndruar me të në dhomë një apo dy net e her 2-3 orë e për gjatë tregimit të tij specifikon se përveç se ishte në dijeni se ata ishin tre vëllezër nga Sh...i dhe i kishte në dhomë – specifikon një fakt se ata ishin gjashtë vëllezër. Për aq kohë sa dëshmitari ka pasur kontakte me ta dhe i ka pasur në dhomë dhe paska qenë në dijeni se edhe nga janë ata vëllezër edhe sa vëllezër janë gjithsej, si është e mundur që dëshmitari të qëndroj me ta e mos të ja di emrin asnjërit prej tyre, edhe në këtë kontekst humbet vet logjika e tregimit të dëshmitarit. Tutje dëshmitari ka rrëfyer se në kohën sa kanë qëndruar tre vëllezërit nga Sh... në L... aty (në çeli) kanë qenë katër veta. Në anën tjetër dëshmitari specifikon se tre vëllezërit nga Sh...i kanë qëndruar me të në çeli e në anën tjetër nuk është i sigurtë se a ka qenë në atë kohë në çeli vetëm ai dhe G.V. siç ka rrëfyer në prokurori, apo ai, F.M, H. e G. siç deklaroi në shqyrtimin gjyqësor. Edhe në këtë kontekst, humbet rrjedha logjike e vet tregimit të dëshmitarit, për faktin se ai ka rrëfyer se kanë qenë vetëm katër persona në çeli përfshi vëllezërit nga Sh...i e pastaj kur përmend emrat e tjerë në dy variantet që jep rezulton që kanë qenë ose pesë persona në çeli ose shtatë.

Në këto rrethana, pasi që dëshmia e dëshmitarit ishte kundërthënëse me vetveten sa i përket faktit se sa kohë kishin qëndruar vëllezërit nga Sh... në L..., cila ishte arsyeja e ndalimit të tyre, se kush kanë qenë të pranishëm kur ka ndodhur rrahja e viktimës së pa identifikuar, se sa veta kanë qenë në çeli në atë kohë kur ishin edhe vëllezërit nga Sh...i aty dhe se si është e mundur që njëri nga këta vëllezër të rrahej me grushte e shkelma deri sa lodheshin të akuzuarit e ai qëndronte në këmbë, e po ashtu mos identifikimi i asnjërit prej këtyre vëllezërve me emër për aq kohë sa ishin në çeli bashke, ka qar në bindjen e kësaj gjykate që mos t'i fal besimin deklarimit të dëshmitarit A përkitazi me përshkrimin faktik që tani kemi objekt shqyrtimi.

Kontradiktat e lartcekura të dëshmitarit A janë arsyet mbi të cilat gjykata nuk i'a ka falur besimin. Nga këto deklarime nuk janë vërtetuar faktet thelbësore të vetë përshkrimit faktik të aktakuzës, e që bëjnë të pa qëndrueshëm përshkrimin faktik të veprës penale për të cilën akuzohen tani të akuzuarin e rrjedhimisht edhe përmbushjen e elementeve të veprës penale, andaj nga këto arsye, gjykata nuk ia fali besimin këtyre deklaratave për faktin se kishte kundërthënie në çështjet kryesore dhe për më tepër dëshmia e dëshmitarit A nuk kishte mbështetje në asnjë provë të vetme e cila provë eventualisht do të rehabilitonte kundërthëniet e dëshmitarit A.

Në bindjen e kësaj gjykate, ka qenë dështim i organit ndjekës, në rastin konkret prokurorisë, që këtë përshkrim faktik të pretenduar e ka bazuar në dëshminë e një dëshmitari të vetëm e kontradiktore, për aq kohë sa është pretenduar se në të njëjtën kohë në çeli paskan qëndruar G.V, F.M, dhe H. e po ashtu tre vëllezër nga Sh... që ishin të ndaluar, ndërsa ata ishin gjithsej gjashtë vëllezër. Në këto rrethana, për gjykatën është i pakuptimte fakti që po që se personat e lartcekur një mend kanë ekzistuar nuk janë identifikuar e marrë në pyetje. Kosova është vend i vogël e fshatet të cilat po përmenden edhe më të vogla që qon në konkludimin që identifikimi i tyre do ishte fare i lehtë, por policia dhe prokuroria aso kohe nuk ka mundur – arritur ti identifikoj, e madje sipas dëshmitarit A i njëjti asnjëherë nuk ka dëgjuar asnjëherë për ta pas luftës, ani pse kishte qëndruar me ditë të tëra me të njëjtin në çeli, (gjithnjë sipas tregimit të tij).

Në këto rrethana, prokuroria ka dështuar ti ofroj prova gjykatës që të arrijë standardin e të provuarit (përtej dyshimit të bazuar), andaj për këtë fakt, nuk ka arritur ta bindë gjykatën se tani të akuzuarit në cilësinë e tyre si pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një personi të paidentifikuar nga lagja Sh... në M..., i ndaluar në qendrën e ndalimit të L..., duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritshme.

Sa i përket provave materiale, si provë e vetme materiale që është administruar në shqyrtimin gjyqësor ka qenë Aplikacioni i dëshmitarit “A” për njohjen e statusit të veteranit, pjesëtarit dhe të internuarit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, respektivisht aplikacioni me numër e datës 11.02.2013, pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, e që gjykata përmes kësaj prove materiale nuk ka arritur që të vërtetojë diçka konkrete e cila ndërlidhet me objektin e aktakuzës. Kjo provë materiale ka të bëjë vetëm me dëshmitarin A ku përmes këtij aplikacioni vetëm vërtetohet fakti se i njëjti aso kohe ka aplikuar për të fituar statusin e veteranit. Tutje, kjo provë materiale është propozuar nga palët vetëm për të matur kredibilitetin e dëshmitarit, por nuk ka asnjë relevancë lidhur me përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës me të cilën janë ngarkuar tani të akuzuarit. Prova materiale e lartcekur ka qenë e administruar në shqyrtimet e kaluara gjyqësore, andaj edhe është administruar edhe në këtë shqyrtim gjyqësor, por rëndësia e kësaj prove përkitazi me rastin ka qenë irelevante. Krejt në fund, specifikojmë faktin se, gjykata kredibilitetin e dëshmitarit e ka matur nga vet deklaratimet e të njëjtit dhe kundërthëniet për faktet konkrete e të cilat u elaboruarn më sipër, e po ashtu edhe në faktin e dëshimitit të prokurorisë në identifikimin e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve të pretenduar, por prova e lartshënuar nuk kishte ndonjë efekt me rastin e vendosjes nga gjykata.

Gjykata ka analizuar edhe deklaratat e të akuzuarve J.D dhe S.S të dhëna në prokurori përkitazi me veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që siç është specifikuar më lartë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi të njëjtit kanë mbështetur këto deklaratat të mbrojtës së tyre dhe se nuk e kanë parë të arsyeshme të deklarohen në shqyrtimin gjyqësor duke e shfrytëzuar të drejtën e tyre për tu mbrojtur në heshtje.

Përgjatë deklaratave të tyre të dhëna në prokurori të njëjtit nuk janë pyetur specifikisht lidhur me objektin e akuzës që i ngarkon, por vetëm lidhur me pjesëmarrjen e tyre në UÇK. Të njëjtit në asnjë moment nuk e kanë mohuar faktin se ata i kanë shërbyer UÇK-së, dhe se të njëjtit po ashtu nuk e kanë mohuar faktin se në L... ka qenë baza e cila ka shërbyer për nevojat shtabit të UÇK-së, andaj nga mbrojtja e tyre, respektivisht deklarami i tyre në asnjë formë nuk ka ndonjë argument apo provë me të cilën do të mund të vërtetoheshin pretendimet e prokurorisë.

Përkitazi me arsyeshmërinë e vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarit A, prokuroria speciale besueshmërinë e të njëjtit e ka bazuar edhe në faktin se trupi gjykues nga EX në gjykimet para se çështja të kthehet në ri-gjykim, i kishte falë besimin këtij dëshmitari.

Në këtë kuptim të pretendimeve të prokurorisë, trupi gjykues ka vlerësuar se me rastin e kthimit të rastit në ri-gjykim, është në diskrecionin e këtij trupi gjykues që të vlerësoj kredibilitetin e dëshmisë së dëshmitarit A. Për më tepër, fakti se kishte dilema edhe në gjykimet e kaluara përkitazi me këtë përshkrim faktik të ndërtuara me tregimin e dëshmitarit A, kishte pasur një aktgjykim lirues fillimisht e pastaj aktgjykim dënues me shumicë votash dhe mendime të ndara – duke i falur besimin dëshmitarit A për përshkrimet tjera faktike e pastaj në atë narativë duke e bërë të besueshëm edhe për këtë përshkrim faktik.

Gjykata aktgjykimin e vet e bazon vetëm në provat që administrohen në shqyrtim gjyqësor, andaj ky trup gjykues ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarit A vetëm përkitazi me përshkrimin faktik të aktakuzës –tani objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor e jo edhe për çështjet tjera që tani kanë përfunduar me aktgjykime të plotfuqishme.

Përfundimisht, nga arsyet e detajuara të lartshënuara, ne bindjen e këtij trupi gjykues, dëshmia e dëshmitarit përkitazi me përshkrimin faktik të aktakuzës është konstatuar si kontradiktore dhe e pa mbështetshme në prova të tjera dhe se e njëjta ka qenë e mangët për të mbështetur pretendimet e prokurorisë, respektivisht shpalljen fajtor të tani të akuzuarve.

Kjo gjykatë me rastin e vlerësimit të provave – ngjarjes dhe pretendimet e palëve në procedurë, specifikon vetëm edhe një fakt, e që prokuroria speciale në fjalën hyrës edhe përfundimtare përshkruan edhe deklaratat e dëshmitarit A kur aj flet për vetveten e vet si i dëmtuar (se si është dërguar në L...), por këto fragmente nuk kanë qenë objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor, për faktin se lidhur me ato pretendime të dëshmitarit A tani aktgjykimet kanë marrë formën e prerë, andaj si të tilla gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e tyre. Kjo gjykatë po ashtu specifikon se në fjalën hyrëse edhe përfundimtare prokuroria gabimisht i referohet disa datave të deklaratave të dëshmitarit A, megjithatë një çështje e tillë është sqaruar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, për faktin se gjykata ka administruar vetëm deklaratat e dëshmitarit që kanë të bëjnë me objektin e shqyrtimit e jo edhe fragmentet e deklaratave për përshkrimet e tjera të aktakuzës të cilat janë përmbyllur me aktgjykime të formës së prerë.

Po ashtu mbrojtësi i të akuzuarit J.D Avokati Mexhid Syla, kishte specifikuar në fjalën e tij përfundimtare se dëshmitari A ishte i njohur për tentim vrasje dhe probleme me familjen D... dhe se kjo cenonte kredibilitetin e tij, megjithatë, kjo gjykatë edhe njëherë rithekson faktin se kredibilitetin e dëshmitarit gjykata e ka matur vetëm me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, respektivisht vetëm nga deklaratat e vet dëshmitarit A, e të cilave kjo gjykatë nuk u'a fali besimin për arsyet e lartshënuara.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale Krimi i luftës kundër popullatës civile nga nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, nenet 31 dhe 152 të KPRK-së - shkelje të rëndë të nenit 3 dhe 4 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës 12 Gusht 1949.

Fillimisht neni 142 i Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ,veprën penale Krime lufte kundër popullatës civile e ka përcaktuar si në vijim citoj “*Kush duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, të konfliktit të armatosur ose të okupacionit urdhëron që kundër popullsisë civile të bëhen vrasje, tortura, sjellje çnjerëzore, eksperimente biologjike, shkaktimin e vuajtjeve të mëdha ose cenime të integritetit trupor apo të shëndetit.*”

Ndërsa neni 152 i KPRK-së veprën penale Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës e ka përcaktuar si në vijim citoj:

- *Kushdo që shkel rënd nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dënohet me burgim së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm*
- *Shkelje e rëndë e nenit 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:*

2.1. *dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;*

2.2. *kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi nënçmues;*

2.3. *marrja e pengjeve;*

2.4. *shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat përgjithësisht njihen si të domosdoshme.*

Sa i përket bashkëkryerjes, neni 22 i Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë kishte përcaktuar bashkëkryerjen citoj : *“Në qoftë se disa persona, duke marrë pjesë në veprimin e ekzekutimit ose në ndonjë mënyrë tjetër kryejnë bashkarisht vepër penale secili nga këta do të dënohet me dënim të parashikuar për këtë vepër”*, ndërsa Kodi Penal i Republikë së Kosovës Kodi Nr.04/L-082, në nenin 31 institutin e bashkëkryerjes e kishte përcaktuar, citoj *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.”*

Fillimisht kjo gjykatë vë në dukje se periudha për të cilën të akuzuarit ngarkohen që kanë kryer veprën penale të përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, përkatësisht periudhën Gusht dhe Shtator 1998 në L... të M..., është fakt notor i njohur për të gjithë se në këtë periudhë kohore ka pasur një konflikt të armatosur në territorin e tani Republikës së Kosovë.

Objekti i akuzës i ngarkon të lartcekurit, se ata kanë rrahur një person të paidentifikuar duke i cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e tij, e cila është në kundërshtim me ligjet që kanë qenë në fuqi aso kohe, dhe e cila është në kundërshtim dhe shkelje të rëndë të nenit 3 dhe 4 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës 12 Gusht 1949.

Vepra penale në pretendimet e prokurorisë, konsiston në atë që të akuzuarit J.D dhe S.S kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e këtij personi të paidentifikuar duke shkelur nenin 3 dhe 4 të neneve të përbashkëta të Konventës së Gjenevës të datës 12 Gusht 1949.

Shkelja e nenit 3 konsiston në ndërmarrjen e veprimeve ndaj personave të cilët nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, e duke ushtruar dhunë ndaj jetës dhe personit, trajtimin mizor, torturën, kryerjen e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, marrjen e pengjeve dhe shqiptimit të dënimeve dhe kryerjen e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat përgjithësisht njihen si të domosdoshme.

Kjo gjykatë për të ilustruar sa më saktë se çka do të përbënte një krim lufte në kuptim të shkeljes së neneve 3 dhe 4 të neneve të përbashkëta të Konventës së Gjenevës të datës 12 Gusht 1949, ka marrë për bazë konkludimet e nxjerra nga vet Tribunalet e formuara për Krime të Luftës.

Kjo gjykatë vë në dukje konstatimet nga Tribunali për Krime Luftë për ish Jugosllavi në rastin S.H, përkatësisht në faqen 11 të Aktgjykimit të këtij Tribunali ishte konstatuar se do të ekzistojë kompetenca lëndore e këtij Tribunali për shkak të shkeljes së të drejtës humanitare të cilat nuk janë përfshirë në nenet 2,4 dhe 5 të Statutit, me ç 'rast duhet të plotësohen këto kushte në mënyrë komulative: (shih rastin S.H, me shenjen IT-01-48-T të datës 16.11.2005) .

- i. duhet të ekzistojë një shkelje e të drejtës humanitare,
- ii. ajo shkelje duhet të konsiderohet shkelje e të drejtës zakonore ndërkombëtare,
- iii. ajo shkelje duhet të jetë e rëndë, përkatësisht duhet të konsistojë në shkeljen e ndonjë rregulli i cili mbron vlera të rëndësishme, ndërsa vet shkelja duhet të shkaktojë pasoja të rënda për viktimën.

Një konstatim i tillë ishte specifikuar edhe nga Paneli i Apelit për ish Jugosllavi, në rastin D.T ku ishte sqaruar se “shkelje e rëndë” nënkupton shkeljen e rregullave me të cilët mbrohen të mirat e rëndësishme dhe se kjo shkelje duhet të inkorporoj në vete pasoja të rënda për viktimën. (shih rastin D.T me shenjen IT-94-1-A të datës 15.07.1999)

Pra ekziston një praktikë e Tribunalit për Krime Luftë për ish Jugosllavi, që thekson se për të konsideruar një veprim shkelje të Nenit 4 paragrafi 2 (a) të Protokollit II të Konventave të Gjenevës pasojat për viktimën e pretenduar duhen të jenë të rënda.

Për më tepër, Statutet e Tribunalit Ndërkombëtar parashohin që vetëm shkeljet “e rënda” të ligjeve dhe zakoneve të krimeve të luftës Brenda juridiksionit të tyre mund të rezultojnë në përgjegjësi penale individuale në përputhje me statutet e tyre. Një shkelje është e rëndë, nëse përbën shkelje të një “rregulle që mbron vlerat e rëndësishme dhe shkelja duhet të ketë pasoja të rënda për viktimën”.

Është praktikë e pranuar në përgjithësi e tribunaleve ndërkombëtare që në mënyrë që kërkesa e gravitetit të përmbushet, shkelja që bëhet duhet të jetë e rëndë, domethënë, duhet të përbëjë një shkelje të një rregulle që mbron vlerat e rëndësishme dhe shkelja duhet të përfshijë pasoja të rënda për viktimën

Kjo gjykatë pas analizës së provës personale përkatësisht deklaratat e dëshmitarit A, nuk ka arritur të krijojë bindjen se të akuzuarit J.D dhe S.S të kenë ndërmarrë veprime kundrejt një personi të paidentifikuar duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritshme, me anë të së cilave veprime do të cenonin shëndetin dhe integritetin e tij, dhe të vërtetohej kështu fakti se këto veprime kanë përfshirë pasoja të rënda për viktimën, pra përmes deklaratimit të këtij dëshmitari nuk është arritur të vërtetohet se a janë ndërmarrë apo jo veprime inkriminuese ndaj personit të pa identifikuar (njërit prej vëllezërve nga Sh..) dhe se çfarë pasoja të rënda i janë shkaktuar, sepse nuk ka pasur asnjë provë tjetër mbështetëse e cila do ta kishte mbështetur dëshminë e dëshmitarit A.

Siç u specifikua më sipër, marr për bazë faktin se gjykata nuk i kishte falur besimin dëshmisë së dëshmitarit A për arsyet e lartshënuara, konkludohet se nga këto deklarime nuk janë vërtetuar faktet thelbësore të vetë përshkrimit faktik të aktakuzës (veprimet inkriminuese të të akuzuarve), me automatizëm e bëjnë të pa mundshëm përshkrimin faktik të veprës penale për të cilën akuzohen tani të akuzuarin e rrjedhimisht edhe përmbushjen e elementeve të veprës penale të kërkuara me nenet 3 dhe 4 të përbashkëta të Konventës së Gjenevës e të ilustruara më sipër me Statutet dhe aktgjykimet e Tribunaleve Ndërkombëtare.

Përfundimisht, nga administrimi i të vetmes provë personale e të cilat janë dëshmitë e dëshmitarit A dhe të vetmen provë materiale e cila nuk ka ndërlidhje me objektin e akuzës, nuk është arritur të vërtetohen veprimet inkriminuese të tani të akuzuarve, veprime këto pastaj që duhet të vërtetonin pasojat e rënda për viktimën e pastaj të përmbushnin e elementet e veprës penale të Krimeve të luftës, që ka qar në përfundimin e kësaj gjykate që nuk është vërtetuar që të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen dhe rrjedhimisht përmbushjen e elementeve të veprës penale Krimi i luftës kundër popullatës civile nga nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, nenet 31 dhe 152 të KPRK-së - shkelje të rëndë të nenit 3 dhe 4 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës 12 Gusht 1949.

Praktika vendore dhe ndërkombëtare për vepra penale të krimeve të luftës

Përveç rasteve si referencë ndërkombëtare nga gjykatat për krime luftë të cilat u specifikuan më sipër si rasti S.H si dhe rasti D.T që kjo gjykate i ka marrë si referencë se çka nënkuptohet shkelje neneve 3 dhe 4 të neneve të përbashkëta të Konventës së Gjenevës që do të nënkuptonte pasoja të rënda për viktimën e rrjedhimisht edhe se si do të përmbusheshin elementet e veprës penale të krimeve të luftës në raste konkrete, gjithnjë duke tërhequr paralele me rastin tonë konkret, kjo gjykatë ka hulumtuar dhe ka marrë për bazë edhe vendime të tjera përkitazi me praktikën vendore dhe ndërkombëtare përkitazi me standardin e të provuarit.

Kjo gjykatë me rastin e marrjes së vendimit dhe përpilimit të këtij aktgjykimi, ka marr për bazë edhe praktikën vendore dhe ndërkombëtare e cila ndërlidhet me veprën penale Krime të luftës, duke marr shembuj nga raste konkrete të cilat janë gjykuar në Tribunale për Krime Luftë për Ish Jugosllavinë me qëllimin e vetëm të ilustrimit – sqarimit, se në raste të ngjashme cili ka qenë standardi i të provuarit që gjykatat e specializuar kanë marr për bazë.

Rastet në vijim të cilat do të elaborohen përgjatë këtij Aktgjykimi ndërlidhen me standardin e të provuarit lidhur me vërtetimin e veprës penale Krime të Luftës, e që kjo gjykatë ka pasur për synim të shpërfaq raste të ngjashme se cili është standardi i provave me të cilat në një rast specifik gjykata mund të shpall dikë fajtor në raste të tilla. Kjo gjykatë ka parasysh faktin se secili rast ka specifikat e veta, megjithatë hulumtimet janë marrë në konkludim të logjikës që mbështet nga gjykatat në raste të ngjashme.

Kjo gjykatë fillimisht specifikon faktin se Aktgjykimet e praktikës tani që ne i konsiderojmë vendore pra nga Trupet gjykuese të EX dhe në vetë rastin e ashtuquajtur D.. I dhe II është specifikuar – konstatuar se në rastet kur kemi të bëjmë me një dëshmi të vetme (aktakuza mbështetet në dëshminë e një dëshmitari dhe jo edhe në prova të tjera përcjellëse) gjykatat duhen të kenë vëmendje të shtuar në vlerësimin e asaj prove duke specifikuar se ajo provë duhet të jetë e qartë e logjishme dhe mos të ketë kontradikta në mes vete dhe vetëm atëherë po që se gjykata nuk ka as edhe një mëdyshje përkitazi me atë dëshmi të shpall të akuzuarit fajtorë.

Në vendimet nga praktika vendore për krime lufte, janë akceptuar standardet e përcaktuara nga Tribunalet për Krime Luftë. (shih Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PA II 11/2016 të datës 03.07.2017, Aktgjykimit PAKR.nr.455/15 të Gjykatës së Apelit të datës 15.09.2016 si dhe ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicës me shenjë P.nr.938/13 të datës 27.05.2015). Narrativen – logjikën e përdorur nga këto gjykata e ka akceptuar edhe kjo gjykatë – pra kjo gjykatë ka marrë për bazë logjikën e nxjerrjes së përfundimeve mbi parimet e lartcekura që mbështetet në vendimet e lartcekura e të cilat si referencë kishin aktgjykimet dhe statutet e Tribunaleve për Krime Luftë, ku disa nga këto raste do ti trajtoj edhe kjo gjykatë në vijim të arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Në vijim të arsyetimit të këtij aktgjykimi do të trajtohen edhe dy raste nga Tribunali për Krime Luftë për ish Jugosllavi si praktikë ndërkombëtare për rastet të krimeve të luftës.

1.Rasti i parë është një rast i cili është gjykuar nga shkalla e I dhe shkalla e II e dhomave të Tribunalit për Ish Jugosllavinë. Në këtë rast i akuzuari V.M akuzohej se ka shkaktuar vuajtje dhe trajtim mizor me dashje, e i cili ka qenë i përfshirë në tri incidente të rrahjeve që kanë ndodhur në zonën e tij të komandës që përfshinin muajt korrik dhe gusht të vitit 1993 ku kanë qenë të përfshirë disa të burgosur, një tjetër incident me një të burgosur të njohur si “P...” si dhe një incident tjetër që ka përfshirë një të burgosur të quajtur T.. Në bazë të këtyre 3 incidenteve, M. është gjet përgjegjës sipas pikave 11 dhe 12 për shkaktimin e qëllimshëm të vuajtje të mëdha dhe trajtim mizor në bazë të neneve 2 (c), 3 dhe 9 (1) të Statutit.

Ky aktgjykim është marrë si referencë për të përshtuar standardin e të provuarit nga ana e Dhomës së Dytë-Dhomës së Apelit, për arsye se në incidentin e referuar me personin me nofkën "P...", ka qenë një person i cili ka mbet i paidentifikuar që pretendohet që i njëjti është rrahur, e që në kohën kur M. u shpall fajtor, personi i quajtur "P..." ende mbeti i paidentifikuar. Fillimisht shkalla e I-rë kishte konstatuar se me rastin e shpalljes fajtor të të akuzuarit M. është mbështetur në dëshminë e dëshmitari OO dhe dëshmitari II. Të njëjtit kanë potencuar se në momentin kur është rrahur personi i paidentifikuar si “P...” ka qenë i pranishëm Dëshmitari OO, e që edhe dëshmitari II i është referuar të njëjtit incident.

Me rastin e vendosjes nga ana e Shkallës së Dytë e njëjta ka konstatuar se Dëshmitari OO dhe II kanë dhënë dëshmi të cilat kanë qenë në përputhje me njëra tjetrën drejtpërsëdrejti me incidentit që ka ndodhur ndaj personit i ashtuquajtur "p..."

Në vendimin e saj Gjykata e Shkallës së II-të ka konstatuar se elementet themelore të dëshmitarëve OO dhe II nuk ndryshojnë në atë masë sa që do të bënte të besueshme se të njëjtit nuk po i referoheshin të njëjtit incident, ku të dy dëshmitarët dëshmuar se rrahja ishte kryer nga M. dhe se ajo përfshinte një person të quajtur "P..." dhe se që ka ndodhur pranë bazës së M..

Me rastin e ankimimit të këtij rasti, Gjykata e shkallës së II-të me këtë rast ka theksuar se sikurse provat në të cilat është mbështetur nga Gjykata e Shkallës së I-rë po që se nuk do të ishin të pranuar ose mënyra se si janë vlerësuar këto dëshmi nuk do të provonin dyshimin a bazuar se i akuzuari M. ka keqtrajtuar personin me nofkën "P...", atëherë Gjykata e Shkallës së II-të do t'i theksonte kundërshtimet e saj që do të kishte në këtë aspekt, e që në rastin konkret Gjykata e Shkallës së I-rë i ka gjetur si të besueshme provat e dëshmitarit OO se i akuzuari M. e kishte rrahur "P..." e që tiparet themelore të këtij incidenti janë vërtetuar edhe nga dëshmia e Dëshmitarit II, e që në këtë rast i akuzuari M. nuk i ka sfiduar në ndonjë mënyrë specifike besueshmërinë e këtyre dëshmitareve, e që tutje Gjykata e Shkallës së II-të ka konstatuar se ka vërtetuar që i akuzuari M. ka kryer veprën penale që i vihet në barrë duke i marrë për bazë të dhënat nga Dëshmitarët OO dhe II (pasi që ato mbështeteshin nga njëra tjetra, nuk ishin kontradiktore, andaj edhe ishin të besueshme).

Kjo gjykatë këtë rast specifik e ka marrë si mostër për të treguar standardin e të provuarit lidhur me veprën penale Krime Luftë, pasi që fillimisht të akuzuarit J.D dhe S.S nuk do të mund të shpallëshin fajtorë duke u mbështetur vetëm në deklaratën e dëshmitarit A, për arsye se deklarata e tij nuk ka gjetur fillimisht përputhje mes deklarimeve që i njëjti ka dhënë në prokurori dhe gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësorë, e që dëshmia e tij nuk është përforcuar as edhe nga një dëshmitar tjetër duke marrë parasysh se i njëjti ka pretenduar se ka identifikuar edhe persona të tjerë të cilët kanë qëndruar në qelinë që ka pretenduar i njëjti duke mos i përmendur vetëm në bazë të "nofkave" të cilët ata kanë pasur por duke përmendur emra dhe mbiemra si F.M, H. M. dhe G.V. (e që prokuroria ka dështuar të identifikon – provoj po që se këta persona kanë qenë persona real ose jo e të cilët potencialisht do të fuqizonin ose jo dëshminë e dëshmitarit A). Nga Aktgjykimi i lartcekur edhe pse viktimja ka qenë e paidentifikuar, baza mbi të cilën i akuzuari M. është shpallur fajtor për rrahjen e këtij të burgosuri të ashtuquajtur "P...", është marrë për bazë Deklarata e 2 dëshmitareve të cilët kanë përshkruar mënyrën se si ka ndodhur ngjarja. (Shih rastin N. dhe M. me shenjën IT-98-34-A të datës 03.05.2006) . Në këtë rast dy dëshmitarët e kanë përshkruar në mënyrë të saktë ngjarjen dhe se Gjykata e shkallës së dytë kishte theksuar se po që se deklaratat e këtyre dëshmitareve nuk do të ishin në përputhje të plotë lidhur me ngjarjen, nuk do të arrihej standardi i të provuarit për shpalljen fajtor të të akuzuarit, e që shpërfaq haptazi konkludimin e kësaj gjykate se në standardin e krijuar nga vet Gjykatat ndërkombëtare për krime luftë, rezultojnë se ky standard nuk është arritur në rastin tonë konkret me një dëshmi të vetme, kontradiktore e të pa mbështetur në prova të tjera. Pra në rastin e lartcekur, Gjykata e shkallës së dytë ka konfirmuar fajësinë e të pandehurit për faktin se kishte dy dëshmitar dhe se kishte përputhje për faktet kryesore mes këtyre dëshmitarëve, ndërsa në rastin tonë konkret kemi vetëm një dëshmitar të pa mbështetur në asnjë provë dhe se kjo deklaratë e dëshmitarit siç është arsyetuar më sipër ishte kontradiktore për faktet kryesore.

2.Rasti tjetër i cili ka të bëjë me keqtrajtimet është edhe rasti i njohur si "Q..." i cili ngarkon të akuzuarin E.L në cilësinë e rojës së kampit të burgut Q..., në cilësi të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë për krimet të cilat dënohen sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare, përkatësisht

i njëjti akuzohej për torturë, shkelje të rëndë sipas nenit 2 (b) të Statutit dhe shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës të dënueshme sipas nenit 3 të Statutit. Këto akuza kanë të bëjnë me veprimet dhe mosveprimet e tij të supozuara në lidhje me disa individë përbrenda kampit të burgut Q... I njëjti akuzohej se së bashku me H.D e kishin nxjerrë nga Hangari VI M.B i kanë vu disa maska në kokë dhe së bashku me disa tjetër e rrahën dhe se e kanë goditur me disa mjete të prehta.

Gjykata e shkallës së parë ka dëgjuar dëshminë e vetme të dëshmitarit M.B lidhur me ngjarjen e pretenduar, dhe se gjykata pas dëgjimit të dëshmisë së këtij dëshmitari nuk e ka konsideruar dëshminë e M.B si të besueshme, dhe në mungesë të provave që do ta mbështesnin dëshminë e këtij dëshmitari nuk ka arritur që të vërtetojë deklarinimin e këtij dëshmitari dhe për këtë arsye Gjykata e Shkallës së I-rë të njëjtit i ka liruar nga akuza. (Shih vendimin Q... me shenjen IT-96-21-T të datës 16.11.1998). Ky aktgjykim më këtë konstatim të gjykatës është aktgjykim i formës së prerë.

Nga rasti i lartcekur, vërehet se i akuzuari E.L ishte shpallur i pafajshëm lidhur me akuzat se i njëjti ka rrahur M.B në kamp-burgun Q... Gjykata me rastin e vlerësimit të dëshmisë së vetme në këtë rast të M.B nuk e ka konsideruar si dëshmi të besueshme, duke marrë parasysh se dëshmia e tij nuk ka pasur përputhje, e po ashtu nuk ka gjetur mbështetje në asnjë provë të vetme përgjatë shqyrtimit gjyqësorë.

Ky rast ndërlidhet edhe me aktgjykimin e tanishëm (pra me rastin tonë konkret), për arsye se fillimisht dëshmia e dëshmitarit "A" kishte mos përputhje mes vete, e po ashtu kjo dëshmi e këtij dëshmitari nuk gjente mbështetje as edhe në ndonjë provë tjetër qoftë personale ose materiale e cila do të bënte të besueshme deklaratat e këtij dëshmitari lidhur me incidentin e pretenduar.

Andaj, në standardin e krijuara nga gjykatat ndërkombëtare, është specifikuar se në një rast konkret, për aq kohë sa aktakuza mbështetet vetëm në një dëshmitar dhe se deklaratat e dëshmitarit kanë kundërthënie mes vete dhe të njëjtat deklarata nuk gjejnë mbështetje në një provë tjetër, nuk mund të arrijnë standardin e të provuarit në këto raste, e që në logjikë dhe bindje të njëjtë vendosi edhe kjo gjykatë lidhur me pretendimet e prokurorisë.

Narativa e logjikës së prokurorisë, si në rastin e lartcekur të ashtuquajtur "Q..." e si në rastin tonë konkret, është identike në kuptim të pretendimeve të provueshmërisë së fakteve, ku faktet janë pretenduar të vërtetohen me një provë të vetme dhe pa mbështetje në prova tjera, e siç u specifikua edhe më lart, Tribunali për Krime Luftë për ish Jugosllavi – në rastin e ashtuquajtur "Q..." kishte konstatuar se për aq kohë sa prokuroria posedon vetëm me një provë – dëshminë e një dëshmitari dhe se ajo provë është kontradiktore dhe nuk mbështetet në prova të tjera, nuk arrihet standardi i të provuarit për tej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale. Andaj edhe kjo gjykatë, ka pasur logjikën e njëjtë dhe se pasi që dëshmia e dëshmitarit A në bindjen e këtij trupi gjykues ishte kontradiktore për arsyet e lartshënuara dhe fakti se ajo dëshmi nuk gjente mbështetje në asnjë provë të vetme, kjo gjykatë ka nxjerrë përfundimin se nuk është arritur standardi i të provuarit në rastin konkret.

Analizë ligjore të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të cilat kjo gjykatë i ka marr për bazë me rastin e vendosjes në këtë çështje penale.

Me rastin e marrjes së këtij aktgjykimi, gjykata ka analizuar dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale e po ashtu dispozita nga Konventa Evropiane e për të Drejtat e Njeriut si dhe Kushtetuta e Republikës Kosovës, dispozita këto imperative që kanë pasur impakt kyç në marrjen e këtij aktgjykimi.

Siç është elaboruar më sipër tek kronologjia e këtij rasti, është sqaruar se Gjykata Supreme me vendimin e saj PML.KZZ.nr.233/2017 të datës 11.06.2018 çështjen e kishte kthyer në ri-gjykim, pasi që Gjykata Supreme ka vlerësuar se përbërja e trupit gjykues ka qenë në kundërshtim me ligjin.

Pasi që lënda është proceduar nga Gjykata Themelore Mitrovicë, në Departamentin Special të kësaj gjykate, kjo gjykatë ka proceduar me rastin në kompetencë të këtij departamenti, ashtu siç e specifikon neni 25 paragrafi 4 i Kodit të Procedurës: *Në procedurën penale në kuadër të Departamentit Special të gjykatës themelore, rasti gjykohet nga trupi gjykues i përbërë nga tre (3) gjyqtarë, të caktuar në atë departament, njëri nga të cilët kryeson trupin gjykues.*

Në rastin konkret, procedura është zhvilluar pranë këtij departamenti e ku të gjithë gjyqtarët kanë qenë gjyqtarë të departamentit special.

Siç është elaboruar për gjatë arsytimit të këtij aktgjykimi, gjykata kishte aprovuar kërkesën e palëve për leximin e deklaratave të dëshmitarit A (për më tepër shih arsyetimin e aktgjykimit dhe procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor), ndërsa në këtë pjesë të aktgjykimit gjykata do të specifikoj vetëm bazën ligjore në të cilën e ka mbështetur trupin gjykues këtë vendim.

Përkitazi me bazën ligjore të lartcekur ku trupi gjykues ka mbështetur vendimin e tij për leximin e këtyre deklaratave të dëshmitarit A, mbështetet në Nenin 307 paragrafin 3 të Kodit të Procedurës.

Në nenin 307 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës është specifikuar si vijon: *Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se gjashtë (6) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishitas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit.*

Në rastin konkret, shtyrja kishte zgjatur më shumë se gjashtë (6) muaj dhe se shqyrtimi ishte mbajtur nga një kryetar tjetër i trupit gjykues, por mbështetet në mundësinë ligjore që i jep gjykatës neni 307 paragrafi 3, trupi gjykues pasi që kishte pasur propozim të të gjitha palëve në procedure që deklaratat e dëshmitarit A të lexohen, në mbështetje të kësaj dispozite e nga arsyet e lartshënuara, trupi gjykues kishte aprovuar propozimin dhe kishte lexuar deklaratat e dëshmitarit A.

Për më tepër, në nenin Neni 335 të Kodit të Procedurës është paraparë mundësia e Leximet të deklaratave të tjera të dhëna më parë. Në nenin 335 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës është specifikuar si vijon: *kur palët pajtohen që, në vend të marrjes së drejtpërdrejt në pyetje të dëshmitarit apo ekspertit i cili nuk është i pranishëm, pavarësisht se ka qenë i thirrur, të lexohet procesverbali mbi dëshminë e tij të mëparshme.* Andaj në kuptim të nenit 307 paragrafi 3 dhe nenin 335 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës ishin lexuar deklaratat e dëshmitarit A dhe ishte proceduar tutje me shqyrtimin gjyqësor.

Përveç bazës ligjore të lartcekur, ky vendim i trupit gjykues është mbështetur edhe nisur nga parimet baze të nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e të inkuorporuara edhe në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për faktin se kjo gjykatë ka vlerësuar se procedura penale ndaj të akuzuarve është tej zgjatur pasi që aktakuza ndaj të lartcekurve ishte ngritur në vitin 2013, ndërsa rasti ishte thyer në rigjykim në vitin 2018, andaj çdo zvarritje edhe më e madhe në këtë rast do të prekte vlerat e mbrojtura me konventën e lartcekur.

Kjo gjykatë me rastin e vendosjes, tërheq vëmendjen edhe në Nenin 7 të Kodit të Procedurës, në të cilën dispozitë është trajtuar Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve.

Në paragrafin 1 të nenit të lartcekur është specifikuar si vijon: *Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.* Tutje në paragrafin 2 po të njëjtit nen është specifikuar si vijon: *Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.*

Në rastin konkret, nën obligimin e nenit 7 të Kodit të Procedurës, gjykata nuk ka arritur të vërtetojë faktet ashtu siç ka pretenduar prokuroria, dhe për më tepër duke u lidhur më tej me nenin 9 të Kodit të Procedurës, që i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë, në këndvështrimin e gjykatës, prokuroria ka dështuar të ofroj prova si organ i akuzës për të vërtetuar faktet të cilat i ka pretenduar me përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës. Në nenin 8 të Kodit të Procedurës është trajtuar Parimi i pavarësisë së gjykatës.

Në paragrafin të këtij neni është specifikuar si vijon: *Gjykata në punën e saj është e pavarur dhe vendos në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.* Në paragrafin 2 të këtij neni është specifikuar si vijon: *Gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor.* Duke u mbështetur në dispozitat e lartcekura, gjykata merr vendimin e saj në bazë të ligjit dhe në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtimin gjyqësor, me ç' rast prokuroria speciale ka dështuar të ofroj prova për të mbështetur standardin e të provuarit ashtu siç e përcakton ligji.

Siç u specifikua edhe më sipër për gjatë arsytimit të këtij aktgjykimi, në nenin 9 të Kodit të Procedurës është përcaktuar Barazia e palëve:

Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.

Prokuroria si palë në procedurë (përfaqëson organin e akuzës). Është nën domenin dhe kompetencën ekskluzive të prokurorisë të mbledhë prova për të bindur gjykatën se të akuzuarit kanë kryer veprën penale të pretenduar. Më tej, siç është specifikuar edhe më sipër për gjatë arsytimit të aktgjykimit dëshmitari A, ka përmendur edhe “persona të tjerë që kanë qenë me të në L...” persona këta që kurrë nuk janë identifikuar nga prokuroria për të mbështetur dëshminë e dëshmitarit A, e për më tepër prokuroria kur nuk ka dhënë përgjigje në faktin po që se ka ndërmarr veprime të paktën të identifikoj po që se këta persona kanë ekzistuar ose jo. Andaj në mungesë të këtyre argumenteve dhe ndërmartjes së veprimeve, prokuroria ka dështuar si organ akuzues të ofroj prova për shpalljen fajtor të tani akuzuarve.

Kjo gjykatë do të jap një sqarim lidhur me nenin 257 të Kodit të Procedurës për faktin, sepse edhe kjo çështje është ngritur përgjatë shqyrtimit gjyqësor:

Neni 257 specifikon Kufizimet e provave ku është përcaktuar si vijon: 1. *Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.* 2. *Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaramit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit.* 3. *Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.*

4. Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues

Kjo gjykatë sqaron se gjykata nuk e ka mbështetur aktgjykimin e vet në nenin 257.

Dëshmitari A nuk ka qenë dëshmitarë bashkëpunues, dhe se identiteti i tij ka qenë i njohur për mbrojtjen dhe të akuzuarin, për faktin se dëshmitari A ka qenë anonim vetëm për publikun.

Pra, gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit A si provë në shqyrtim gjyqësor dhe si prove që nuk ka pasur kufizime për shpalljen fajtor të të akuzuarve, por të njëjtës prove gjykata nuk i'a ka falur besimin për arsyet tani më të konstatuara në këtë aktgjykim. Po ashtu gjykata nuk i ka liruuar të akuzuarit nga akuza me argumentin se viktimja nuk është identifikuar, pasi që Tribunalet ndërkombëtare siç është elaboruar më sipër nuk e kërkojnë këtë kriter, andaj nuk e ka kërkuar as kjo gjykatë, por për këtë gjykatë dëshmia e dëshmitarit A ishte kontradiktore dhe si e tillë jo-kredibile dhe se e njëjta nuk gjende mbështetje në prova të tjera, andaj kjo ishte baza – argumenti mbi të cilin gjykata i liroji tani të akuzuarit.

Në nenin 19 të Kodit të Procedurës, janë dhënë sqarime mbi përkufizimet se çka nënkuptohet me termat përkatës të këtij Kodi.

Në nenin 19, paragrafi 1, nën paragrafi 1.12 është sqaruar se çka nënkupton Dyshimi i bazuar mirë -:

Nënkupton bazën për ngritjen e aktakuzës. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri. Tutje, për shpalljen fajtor të një të akuzuari, kërkohet një standard edhe më i lartë se dyshimi i bazuar (përtej çdo dyshimi) që të bindet një vëzhgues objektiv se të akuzuarit kanë kryer veprën penale.

Në rastin konkret, në bindje e kësaj gjykate, nuk mundet në asnjë formë të bindet një vëzhgues objektiv se të akuzuarit kanë kryer veprën penale, për aq kohë sa pretendimet e prokurorisë mbështeten vetëm në një dëshmi të vetme e cila dëshmi nuk ka mbështetje në as edhe një prove dhe se e njëjta dëshmi për zbulimin e fakteve thelbësore është kontradiktore. (shih deklaratat e dhëna – arsyet e gjykatës për mos faljen e besimit të dëshmitarit A).

Në nenin 3 Të Kodit të Procedurës Penale është përcaktuar, Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe parimi, In Dubio Pro Reo.

Në paragrafin 1 të nenit 3 është përcaktuar si vijon: *Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.*

Në paragrafin 2 të nenit 3 është përcaktuar si vijon:

Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në rastin konkret, në bindjen e gjykatës, me rastin e kthimit të çështjes në ri-gjykim, pretendimet e prokurorisë speciale në aktakuzë kanë qenë supozuese mbi bazën e asaj që të akuzuarit janë shpallë fajtor për përkrahje të tjera faktike me deklaratë të dëshmitarit A, andaj në këtë formë është mbështetur edhe ky përkrahje faktik i aktakuzës, por ky përkrahje faktik, në bindjen e kësaj gjykate, nuk ka gjetur mbështetje në as edhe një prove bindëse.

Kjo gjykatë, duke interpretuar paragrafin 2 të nenit 3 të Kodit të Procedurës, specifikon faktin se, marr për bazë që përkrahje faktik i aktakuzës është mbështetur në një prove të vetme – deklaratën e dëshmitarit A, dhe faktin se deklaratat e dëshmitarit A kanë qenë kontradiktore për faktet thelbësore dhe atë: fillimisht si dhe sa e kanë rrahur të akuzuarit viktimën e panjohur, sa ka qëndruar viktimja e pretenduar në fshatin L..., kush ishin të pranishmi kur të akuzuarit e kishin rrahur atë, sa kishte zgjatur goditjet e të akuzuarve ndaj viktimës, si ishte e mundur se në bazë të

deklaratave të dëshmitarit A të akuzuarit e kishin rrahur pa ndërpre deri sa ishin lodhur e në anën tjetër viktima qëndronte në këmbë dhe se cilat ishin pasojat e mëdha për viktimën. Të gjitha këto fakte të pa vërtetuara në mënyrë precize, kanë lënë mëdyshje të thella lidhur me pretendimet e prokurorisë – përshkrimin faktik të aktakuzës. Në këtë logjikë, deklaramet e dëshmitarit A përkitazi me pjesët kyçe të përshkrimit faktik kanë pasur kontradikta të thella me ç’ rast nuk ka mundur të ndërtohet një përshkrim faktik i qëndrueshëm për shpalljen fajtor të tani të akuzuarve e që në mbështetje të kësaj dispozite imperative (parimin in dubio pro reo), gjykata të gjitha këto mëdyshje i interpretoi në favorin e të akuzuarve, me ç’ rast të njëjtit i liroi nga aktakuza.

Në nenin 360 të Kodi të Procedurës është trajtuar Baza e aktgjykimit.

Në paragrafin 1 të këtij neni është specifikuar si vijon: *Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor*. Ndërsa në paragrafin 2 të po të njëjtit neni është specifikuar si vijon: *Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar*.

Në rastin konkret, përgjatë shqyrtimit gjyqësor, është paraqitur vetëm një prove nga organi akuzës e që është dëshmia e dëshmitarit A. Gjykata sipas dispozitës se lartcekur *detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar*. Kjo gjykatë nuk ka pasur as edhe një provë tjetër të vetme mbi bazën e të cilës do ta ndërlidhte atë me dëshminë e dëshmitarit A, për të nxjerr përfundime për faktet, kjo pasi që prokuroria ka dështuar të sjellë prova të tjera mbi bazën e të cilave do të mund të bëhej ndonjë lidhshmëri për tu provuar faktet e pretenduara në përshkrimin faktit të dispozitivit të aktakuzës, e që rrjedhimisht kjo gjykatë konstaton se në mungesë të provave fakti i pretenduar nga prokuroria nuk është provuar.

Për aq kohë sa gjykata ka konkluduar se nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzoheshin, kjo gjykatë aktgjykimin e vet e bazon në nenin 363 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 ku është specifikuar se: *Gjykata merr aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuzat nëse: nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet*.

Përfundimi

Kjo gjykatë, pasi ka vlerësuar provën e vetme të ofruar në shqyrtimin gjyqësor nga organi i akuzës, pra deklaramet e dëshmitarit A, të njëjtave deklarata kjo gjykatë nuk u'a fali besimin për arsyet që kjo gjykatë në detaje i ka dhënë më sipër për kontradiktoritein e këtyre deklaratave. Tutje, kjo gjykatë po ashtu duke u mbështetur në Praktikën gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare që është sqaruar e tërhequr paralele që kjo gjykatë i ka trajtuar më sipër përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi e të cilat i ka marrë si reference të argumenteve se cili është standardi i të provuarit në këto raste, ka konkluduar se provat e ofruar nga prokuroria nuk përmbushin standardin e të provuarit në rastin konkret. Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në analizën e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të elaboruar më sipër, kjo gjykatë ka nxjerrë përfundimin se : Në një datë të papërcaktuar të muajit gusht ose shtator të vitit 1998, të akuzuarit akuzohen se kanë kryer Krime lufte kundër popullatës civile, që parashihet dhe dënohet me nenet 22 dhe 142 të Ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale (e që në kohën e ngritjes së aktakuzës ishin penalizuar me nenet 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës), në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët dhe nenin 4 të protokollit shtesë dhe të gjitha rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë aktakuzë, i akuzuari J.D në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në bashkëkryerje me S.S po ashtu në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë

cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një personi të pidentifikuar nga lagja Sh... në M..., i ndaluar në qendrën e ndalimit të L..., duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritshme.

Krejt në fund, gjykata sqaron se të akuzuarit i liroj nga aktakuza për dispozitivin VI pikës III si dhe dispozitivin XIII pika VI të aktakuzës, por përshkrimi i veprës penale u përshkrua vetëm një here, sepse kemi të bëjmë me të njëjtin përshkrim faktik.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 462 paragrafi 1 dhe 3 të KPPRK-së, i ka liruar të akuzuarit nga shpenzimet e procedurës për arsye se të njëjtit i ka liruar nga akuza.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të nenit 361 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti Special
PPS.nr.12/24 të datës 18.06.2024

Kryetari i trupit gjykues

Ngadhnjim Arrni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.